



Universiteti i Prishtinës

**STRATEGJIA PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE
SHKENCORE/ARTISTIKE DHE ZHVILLIMORE
2013-2016**

Prishtinë, nëntor 2012

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

STRATEGJIA PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE-SHKENCORE/ARTISTIKE DHE ZHVILLIMORE 2013-2016

Hartuesit:

Dr.sc. Avdulla Alija

Dr.sc. Bajram Berisha

Mr.sc. But Dedaj

Dr.sc. Dukagjin Pupovci, redaktor

Dr.sc. Hysen Bytyqi

Dr.sc. Shemsedin Dreshaj

M.Sc. Alfred Marleku

M.Sc. Mjellma Carabregu

Ky dokument u miratua nga Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me
20.11.2012.

Ky projekt është financuar në kuadër të Programit Tempus të Bashkimit Evropian i cili finanohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillim dhe Bashkëpunim – EuropeAid dhe Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim.

Ky dokument reflekton vetëm pikëpamjet e autorëve, Agjencia për Edukim, Audiovizualitet e Kulturë dhe Komisioni Evropian nuk mund të mbahen përgjegjës për përdorimin e asnjë informate që përmban dokumenti



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Fjala e Rektorit	5
Përmbledhje ekzekutive	6
1. Hyrje	9
2. Gjendja e kërkimit shkencor/artistik dhe e zhvillimit në Universitetin e Prishtinës.....	11
2.1. Burimet njerëzore.....	112
2.2. Infrastruktura	13
2.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	14
2.4. Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë	16
3. Objektivat, masat dhe rezultatet e pritshme	18
3.1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.....	189
3.2. Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës	22
3.3. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë	24
3.4. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat.....	27
4. Menaxhimi	28
5. Plani i veprimit dhe buxheti.....	33
Shtojcë: Prioritetet kërkimore sipas Programit Kombëtar të Shkencës	41

Lista e shkurtesave

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
ASO	Zyra Austriake për Shkencë
BE	Bashkimi Evropian
BKUK	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
CITT	Qendra për Inovacione dhe Transfer të teknologjisë
DEZA	Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FP7	Programi Kornizë FP7
HEAL	Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë
IPA	Instrumenti për Asistencë të Para-anëtarësimit
KAIP	Partneriteti Kosovë-Austri në fushën e Arsimit të Lartë dhe të Shkencës
K-CIRT	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Shkencë dhe Teknologji
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
NjHSH	Njësia për Mbështetje të Hulumtimeve Shkencore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKSH	Plani Kombëtar i Shkencës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
PTK	Posta e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RPSO	Zyra Mbështetëse për Hulumtim Shkencor
STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit e Kosovës
TIK	Teknologjia Informativë dhe Komunikuese
USAID	Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
WUS Austria	Shërbimi Universitar Botëror
ZEAL	Zona Evropiane të Arsimit të Lartë
ZZHA	Zyra për Zhvillim Akademik

Fjala e rektorit

Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të menaxhmentit të UP-së, stafit akademik dhe studentëve të përgëzoj grupin punues për hartimin e Strategjisë për veprimtari kërkimore – shkencore/artistike dhe zhvillimore 2013-2016’.

Kjo strategji, e cila është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve nga fusha të ndryshme akademike dhe mbështetet në Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015, do të jetë dokumenti në të cilin mbështetet Universiteti i Prishtinës për të ndërtuar dhe konsoliduar struktura dhe mekanizma që promovojnë kërkim shkencor të një niveli të krahasueshëm me Universitetet prestigjioze nga vendet më të zhvilluara. Kjo strategji, adreson nevojën që të precizohen masat dhe instrumentet që UP si institucion duhet ndërmarrë që kërkimi shkencor të jetë më ngushtë i lidhur me arsimin e lartë por edhe me ndërmarrjet, biznesin dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.

Përmes zbatimit të kësaj strategjie Universiteti i Prishtinës synon të jetë ndër përfituesit kryesorë të fondeve për kërkime shkencore të Republikës së Kosovës dhe të rrisë pjesëmarrjen dhe përfitimet në kuadër të projekteve të financuara nga BE dhe ato ndërkombëtare. Përmes aktiviteteve për promovimin e kërkimeve-shkencore/artistike, përgatitjen e projekt-propozimeve, lidhjen e partneriteteve strategjike, etj., Universiteti i Prishtinës do të rrisë numrin dhe cilësinë projekteve kërkimore, do të forcojë lidhjen e mësimdhënies me kërkime shkencore, do të forcojë partneritetet ekzistuese, do të zgjerojë bashkëpunimin me institucionet kërkimore evropiane si dhe do të përmirësojë kapacitetet e menaxhimit të projekteve. Kjo Strategji do të avancojë edhe marrëdhëniet e Universitetit të Prishtinës me agjencitë qeveritare, me institucionet tjera kërkimore-shkencore, me bizneset dhe fondacionet që kanë të bëjnë me komercializimin e punës dhe pronësisë intelektuale.

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës është shumë i përkushtuar për të zbatuar këtë strategji, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar si dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Gashi, rektor

Përmbledhje ekzekutive

Një vit pas aprovimit të Programit Kombëtar të Shkencës 2010-2015, Universiteti i Prishtinës mori vendim për hartimin e Strategjisë, e cila duhet të sigurojë bashkërenditjen e institucionit më të madh dhe më të vjetër të arsimit të lartë në Kosovë me përpjekjet për avancimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore në nivel vendi. Dokumenti “ Strategjia për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore 2013-2016” është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve nga fusha akademike të ndryshëm dhe u zhvilluar me përkrahjen e projektit “Krijimi i Kapaciteteve dhe Instrumenteve për Hulumtim dhe Zhvillim dhe për Nxitjen e Bashkëpunimit në Fushën e Arsimit të Lartë dhe Ekonomisë” të financuar nga Programi “Tempus” i Komisionit Evropian.

Pikënisje për hartimin e dokumentit strategjik kanë qenë prioritetet për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike të artikuluar në Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015. Universiteti i Prishtinës i konsideron këto si prioritate të veta kërkimore dhe është i përkushtuar t’i ofrojë përkrahje të veçantë njërive akademike, grupeve hulumtuese dhe individëve që bëjnë studime në këto fusha. Po ashtu, Universiteti është i ndërgjegjshëm se, në një të ardhme jo të largët, përqendrimi i kërkimeve që zhvillohen në këtë institucion, duhet të jetë në ato fusha ku kontributi shkencor dhe artistik është më domethënës dhe që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Hapi i parë në procesin e zhvillimit të dokumentit strategjik ka qenë analiza e gjendjes, e cila është bërë në katër fusha:

- Burimet njerëzore
- Infrastruktura
- Bashkëpunimi ndërkombëtar
- Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë

Këto fusha korrespondojnë me ato të Programit Kombëtar të Shkencës, gjë që është e natyrshme, pasi Universiteti i Prishtinës është pasqyrë besnike e gjendjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Kosovë. Për secilën fushë është bërë një analizë SWOT që ka nxjerrë në shesh të arriturat dhe dobësitë e Universitetit të Prishtinës nga këndvështrimi i kapacitetit për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike. Po ashtu, janë analizuar edhe faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen. Analiza ka qenë pikënisje për identifikimin e strategjive të ndryshme për të shfrytëzuar të arriturat dhe për t’i tejkaluar dobësitë, por edhe për të krijuar ide se si mund të përfitohet nga mundësitë që ofron mjedisi dhe si mund të shmangen rreziqet që kërcënojnë.

Për secilën nga katër fushat ku është analizuar gjendja është formuluar nga një objektiv zhvillimor. Objektivat përcaktojnë caqet e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në periudhën vijuese katërvjeçare. Për secilin objektiv janë përcaktuar masat e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo masë janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit. Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e shkurtër e objektivave zhvillimore bashkë me masat e ndërlidhura:

Objektivi 1: Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës.

- 1.1. Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të UP-së bazuar në sistemin e Bolonjës
- 1.2. Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit
- 1.3. Nxitet qasja ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike
- 1.4. Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore-shkencore/artistike.
- 1.5. Nxitet përfshirja e kapaciteteve nga diaspora në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore.
- 1.6. Përcaktohen obligimet kontraktuale për kontribut në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike për personelin akademik.

Objektivi 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe për ofrimin e shërbimeve

- 2.1. Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitetin e Prishtinës
- 2.2. Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të UP-së
- 2.3. Lidhen marrëveshje për shfrytëzim të infrastrukturës kërkimore të institucioneve të tjera në vend dhe jashtë
- 2.4. Themelohen/Funksionalizohen laboratorë dhe institute dhe pajisen me infrastrukturë përkatëse
- 2.5. Sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

- 3.1. Lidhen partneritete strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me UP
- 3.2. Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve.
- 3.3. Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare
- 3.4. Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

- 4.1. Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat
- 4.2. Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkesat e tregut
- 4.3. Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkime
- 4.4. Angazhohen personeli akademik dhe studentet në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore-shkencore

Zbatimi i Strategjisë dhe kërkesat që shtrohen para universitetit bashkëkohor imponojnë nevojën për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Për këtë qëllim, do të fuqizohet Njësia për mbështetje të hulumtimeve shkencore, duke i besuar detyra dhe përgjegjësi të reja. Po ashtu, do të formohet një Grup Këshillëdhënës për punë kërkimore-

shkencore dhe inovacion, i cili do të përcjellë realizimin e Strategjisë dhe do të ofrojë ekspertizën e vet për tejkalimin e problemeve.

Strategjia përmban planin e zbatimit për periudhën tetor 2011-shtator 2015, si dhe kornizën buxhetore që është përmbledhur në tabelën vijuese:

Fusha	Buxheti				
	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16	Gjithsej
Burimet njerëzore	€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 560,000
Infrastruktura	€ 10,000	€ 113,000	€ 250,000	€ 250,000	€ 623,000
Bashkëpunimi ndërkombëtar	€ 55,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 560,000
Lidhja me ekonominë dhe me shoqërinë	€ 0	€ 5,000	€ 0	€ 0	€ 5,000
Menaxhimi	€ 17,150	€ 21,200	€ 21,200	€ 21,200	€ 80,750
Total	€ 222,150	€ 464,200	€ 596,200	€ 596,200	€ 1,828,750

Fondet e nevojshme për implementimin e kësaj Strategjie paraqesin 1 – 3.5% të buxhetit vjetor të Universitetit të Prishtinës (rreth 17 mil. EUR), pa i llogaritur të hyrat vetanake nga veprimtaria akademike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e këtyre shpenzimeve janë bërë edhe deri tani, por jo në mënyrë të rregullt dhe të planifikuar.

1. Hyrje

Në korrik të vitit 2010 Kuvendi i Kosovës aprovoi Programin Kombëtar të Shkencës, dokument zhvillimor bazë që ofron një kornizë konceptuale për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Kosovë, duke përcaktuar prioritetet kërkimore, objektivat zhvillimore, masat për arritjen e tyre, si dhe koston e zbatimit të Programit. Universiteti i Prishtinës, si institucion që zhvillon veprimtarinë e vet arsimore dhe kërkimore-shkencore/artistike po thuhet se në të gjitha fushat e shkencës dhe të artit që janë të përfaqësuara në Kosovë, i ka kontribuar shumë hartimit të Programit Kombëtar të Shkencës, duke e parë veten si zbatues të pjesëve kyçe të tij. Nga ana tjetër, pas përfundimit të procesit të akreditimit institucional dhe të numrit më të madh të programeve, në përputhje me trendët për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), Universiteti i Prishtinës ka adoptuar qëndrimin se duhet të ekzistojë një lidhje organike në mes të funksionit arsimor që ushtron dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike që zhvillon.

Kjo nënkupton se veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike duhet të jetë shoqëruese e natyrshme e të gjitha programeve akademike dhe pjesë e pandashme e veprimtarisë së zakonshme ditore të njësive akademike të Universitetit. Në rastin e Universitetit të Prishtinës kjo nuk duhet të ndodhë vetëm për shkak të konkurrencës me institucione të tjera të arsimit të lartë në Kosovë dhe në Rajon, por, para së gjithash, për shkak të përgjegjësisë që mban Universiteti për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Kosovë, si dhe obligimeve që burojnë nga Statuti. Kjo përgjegjësi del edhe nga fakti se, përkundër vështirësive, Universiteti i Prishtinës është institucioni me predispozita më të mira për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Kosovë, por edhe nga fakti se ky Universitet është institucion publik që është ngritur dhe operon me mjetet e Buxhetit të Kosovës.

Veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike në Universitet nuk ka reshtur as në momentet më të vështira të historisë së tij. Por, në kohën e sotme ajo është më shumë rezultat i nismave individuale të personelit akademik sesa rezultat i aktivitetit të organizuar të njësive akademike dhe grupeve hulumtuese brenda Universitetit. Universiteti e ka për detyrë t'i përkrahë njësitë akademike, grupet hulumtuese dhe individët në ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe, për ta bërë këtë punë me sukses, i duhet të definojë një qasje që duhet të ndiqet me vigjilencë. Ky është pikërisht qëllimi i këtij dokumenti – të shërbejë si udhërrëfyes për mbështetjen dhe organizimin e punës kërkimore-shkencore në Universitet.

Aktivitetet për hartimin e Strategjisë për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike filluan në korrik të vitit 2011 kur Universiteti i Prishtinës emëroi një grup të punës në këtë përbërje: Dr.sc. Mujë Rugova, Dr.sc. Bajram Berisha, Dr.sc. Enver Kutllovci, Dr.sc. Naser Mrasori, Dr.sc. Dukagjin Pupovci, Dr.sc. Hajrije Hundozi-Hysenaj, Dr.sc. Ramë Vataj, Dr.sc. Avdulla Alija, Dr.sc. Ferdije Zhushi-Etemi, Dr.sc. Tahir Arbneshi, Dr.sc. Shemsedin Dreshaj, Dr.sc. Linda Grapci, Dr.sc. Myzafere Limani, Mag. Almir Kovacevic, Dr.sc. Tahire Maloku-Gjergji, Dr.sc. Murteza Osdautaj, Dr.sc. Hysen Bytyçi, Mr.sc. But Dedaj, M.Sc. Mjellma Carabregu dhe M.Sc. Alfred Marleku. Pas diskutimit të metodologjisë së punës në Grup, hartimi i draftit të parë iu besua nëngrupit në përbërje: Dr.sc. Avdulla Alija, Dr.sc. Bajram Berisha, Mr.Sc. But Dedaj, Dr.sc. Dukagjin Pupovci, Dr.sc. Hysen Bytyqi dhe Dr.sc. Shemsedin Dreshaj, M.Sc. Alfred Marleku dhe M.Sc. Mjellma Carabregu. Nëngrupi punoi me intensitet mjaft të madh gjatë korrikut dhe gushtit të vitit 2011 me përkrahjen e projektit: “Krijimi i Kapaciteteve dhe Instrumenteve për Hulumtim dhe Zhvillim dhe për Nxitjen e Bashkëpunimit në Fushën e Arsimit

të Lartë dhe Ekonomisë” të financuar nga programi “TEMPUS” i Komisionit Evropian dhe të koordinuar nga Zyra e WUS-Austria në Prishtinë.

Fillimisht, u analizuan dokumentet ekzistuese si: Raporti i Vetëvlerësimit i Universitetit të Prishtinës i vitit 2008, Rekomandimet për organizmin e punës kërkimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës të hartuara nga Projekti i Partneritetit Kosovë-Austri në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës (KAIP), Strategjia zhvillimore e Universitetit të Prishtinës, Programi Kombëtar i Shkencës 2011-2016, etj. Pastaj, u bë një analizë “SWOT” e gjendjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës, duke identifikuar në mënyrë analitike sukseset dhe dobësitë që ka demonstruar institucioni, por edhe mundësitë dhe rreziqet që mund të vijnë nga mjedisi në të ardhmen. Vet analiza është bazuar në dokumentet e përmendura më lartë dhe të dhënat e ofruara nga Universiteti i Prishtinës. Gjatë analizës janë identifikuar katër fusha relevante për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore: 1) Burimet njerëzore, 2) Infrastruktura, 3) Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe 4) Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë.

Hapi i radhës ka qenë gjetja e mënyrave më të mira për fuqizimin e sukseseve të identifikuara dhe eliminimin e dobësive, si dhe për përfitim nga mundësitë që ofron mjedisi dhe për shmangie nga rreziqet që mund të na kërcënojnë në të ardhmen. Kështu janë identifikuar objektivat zhvillimore dhe masat për arritjen e tyre, për të vazhduar pastaj me përshkrimin e masave dhe përcaktimin e treguesve të suksesit. E gjithë kjo ka rezultuar me një draft dokument, i cili është diskutuar nga një grup më i gjerë ekspertësh me 3 dhe 4 shtator të vitit 2011, duke i bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme. Në këtë punëtori është zhvilluar edhe plani i veprimit të Strategjisë dhe është përcaktuar korniza buxhetore e saj.

Një çështje që është diskutuar mjaft janë prioritetet kërkimore-shkencore/artistike. Universiteti e ka të qartë se, në një të ardhme, veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike duhet të përqendrohet në disa fusha ku kontributi për zhvillimin e vendit dhe për afirmimin ndërkombëtar të Universitetit mund të jetë më i madh, por, momentalisht, këto fusha nuk mund të përkufizohen qartë. Në fakt, veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike në Kosovë është në një gjendje letargjie dhe Universiteti konsideron se të gjitha fushat kanë nevojë për t’u zhvilluar, në mënyrë që pastaj të diferencohen vet ato fusha ku mund të pritët kontribut më i madh i Universitetit. Nga ana tjetër, prioritetet kërkimore të Kosovës për periudhën 2010-2015 janë filtruar nga një listë e gjatë e aktiviteteve të mundshme gjatë procesit të hartimit të Programit Kombëtar të Shkencës 2010-2015 dhe, në një masë, janë harmonizuar edhe me vendet e tjera të Rajonit. Prandaj, është e pritshme që këto fusha do të trajtohen me përparësi nga financuesit vendorë dhe ndërkombëtarë të punës kërkimore-shkencore/artistike. Për këto arsye, Universiteti i Prishtinës i pranon prioritetet e përcaktuara në Programin Kombëtar të Shkencës si prioritete të veta kërkimore për periudhën 2011-2015. Këto prioritete janë dhënë, në formë të përmbledhur, në shtojcën e këtij dokumenti.

Me gjithë faktin se ishte paraparë që dokumenti të diskutohej në Senatin e Universitetit të Prishtinës në tetor të vitit 2011 dhe të merrej vendimi formal për aprovimin e tij, kjo nuk ndodhi. Pas marrjes së detyrës nga menaxhmenti i ri në tetor 2012, u bë një rishikim i dokumentit, duke bërë ndryshime në përshkrimin e gjendjes, në disa aktivitete, si dhe në afatet e zbatimit të tyre. Po ashtu, u ndryshua edhe periudha e vlefshmërisë së dokumentit, duke e lidhur atë me dokumentet tjera relevante. Dokumenti është dërguar për komente dhe sugjerime në të gjitha njësitë akademike dhe pastaj është miratuar në mbledhjen e senatit me datë 20. 11. 2012.

2. Gjendja e kërkimit shkencor/artistik dhe e zhvillimit në Universitetin e Prishtinës

Janë identifikuar katër fusha për analizën e gjendjes në Universitetin e Prishtinës:

- Burimet njerëzore;
- Infrastruktura;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe
- Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë.

Me gjithë se emërtimet e fushave të identifikuara kanë dalë nga dokumentet e shumta dhe vet analiza e gjendjes, ekziston një konsensus i plotë se këto janë çështjet që duhet marrë parasysh me rastin e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës.

Në çdo institucion, burimet njerëzore janë pasuria më e madhe dhe parakushti themelor për organizimin e mirë të punës. Infrastruktura e mirë që përfshin: ndërtesat, pajisjet laboratorike dhe bibliotekat mundëson një shkallë më të lartë të organizimit dhe siguron arritjen e rezultateve relevante në kërkime. Ndërkaq, zhvillimi i suksesshëm i veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike kërkon një komunikim të vazhdueshëm me botën në funksion të realizimit të projekteve të përbashkëta kërkimore. Me gjithë se ekonomia dhe shoqëria në Kosovë kanë kapacitet të limituar për të absorbuar të arriturat e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike, priten përmirësime në këtë drejtim, prandaj është e domosdoshme të krijohet një ndërlidhje në mes të punës kërkimore dhe efekteve të saj në shoqëri dhe në ekonomi.

2.1. Burimet njerëzore

Universiteti i Prishtinës ka traditë të qëndrueshme akademike si universiteti më i vjetër në vend. Roli i këtij institucioni është mësimdhënia dhe kërkimi-shkencor/artistik. Universiteti i Prishtinës përmes stafit akademik që ka, është promotor i zhvillimit intelektual, zhvillimit të komunitetit të dijes e shkencës, si dhe zhvillimit ekonomik në vend. Personeli mësimor i Universitetit të Prishtinës nëntor të vitit 2012 përbëhet nga 1,023 të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune dhe rreth 400 të angazhuar me orar të pjesshëm pune (honorar). Aktualisht, numri i përgjithshëm i stafit administrativ dhe mbështetës në Universitetin e Prishtinës është 325.

Zhvillimi i hulumtimit shkencor dhe artistik në të kaluarën në Universitetin e Prishtinës ishte i një niveli solid për periudhat përkatëse, edhe

Disa nga sfidat

- Mungesë e motivimit dhe stimulimit për marrje me veprimtari kërkimore-shkencore;
- Mungesë e përvojës dhe kapaciteteve në njësitë akademike të ndryshme në Universitetin e Prishtinës për sigurimin e fondeve përmes projekteve;
- Diversifikim i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore ekzistuese për përmbushjen e nevojave në Universitetin e Prishtinës;
- Aktivitete kërkimore sporadike dhe anësore, bazuar kryesisht në nisma individuale.

pse karakterizohet me shpërndarje jo-uniforme në njësi akademike dhe departamente të ndryshme brenda Universitetit të Prishtinës. Megjithatë, si pasojë e një shkëputjeje të gjatë të komunikimit akademik me institucione të tjera për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe luftës në Kosovë (1991-1999); raportit jo të kënaqshëm në mes të punës kërkimore dhe mësimdhënies; mungesës së hulumtimeve ndërdisiplinare; mungesës së theksuar të njohjes së gjuhës angleze për të realizuar projekte të përbashkëta me institucionet dhe hulumtuesit shkencor jashtë vendit dhe zhvillimit të ngadalshëm ekonomik në vend, momentalisht veprimtaria hulumtuese në këtë institucion nuk mund të krahasohet me atë të institucioneve simotra në Evropë. Hulumtimi shkencor në Universitetin e Prishtinës në dy dekadat e fundit është realizuar kryesisht në baza individuale nga personeli akademik me qëllim të ngritjes profesionale-shkencore, si dhe nga studentët me rastin e realizimit të projekteve për arritjen e gradës së caktuar profesionale-shkencore. Në përgjithësi, kapacitetet njerëzore hulumtuese në Universitetin e Prishtinës nuk i mbulojnë të gjitha disiplinat kërkimore-shkencore brenda sektorëve të ndryshëm në Kosovë.

Përkundër vështirësive të përmendura, në Universitetin e Prishtinës ka dëshmi për nisma kërkimore-shkencore/artistike modeste, kryesisht përmes organizimit të studimeve të doktoratës si dhe bashkëpunimit me institucione jashtë vendi. Universiteti i Prishtinës, si institucion publik i arsimit të lartë në vend, me qëllim të kompletimit të aktiviteteve kërkimore-shkencore/artistike në të gjitha fushat, është orientuar drejt zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, veçanërisht për kërkime shkencore të zbatuara dhe për hartimin e programeve zhvillimore. Në përputhje me mundësitë e veta, Universiteti i Prishtinës në baza garuese përkrahë materialisht publikimet e stafit akademik dhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca, simpoziume, kongrese dhe tubime tjera shkencore. Si rezultat i angazhimit individual dhe ekipor të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës janë realizuar publikime në shumë revista dhe simpoziume me karakter vendor dhe ndërkombëtar.

Në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje për problemet ekzistuese për industrinë përkatëse, dhe përafrim sa më të madh të raportit mësim-kërkim, strukturat përgjegjëse dhe stafi i Universitetit të Prishtinës janë të përkushtuar të rrisin intensitetin e aktiviteteve në këtë drejtim. Një nga angazhimet parësore për realizimin e këtij qëllimi është shpërndarja e informacionit për mundësitë e aplikimit për fonde të ndryshme (kombëtare dhe ndërkombëtare), përfshirje më e madhe e stafit të ri akademik dhe studentëve në përgatitjen dhe implementimin e projekteve shkencore hulumtuese në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike, themelimi i njësisë konsultative në kuadër të Universitetit të Prishtinës (grupet “bërthamë”), që mundësojnë bartje të ekspertizës së fituar nga projektet kërkimore në ekonominë e vendit, etj.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve hulumtuese, Universiteti i Prishtinës duhet të merr në konsideratë me prioritet disa vështirësi (rreziqe) të cilat mund të paraqesin efekte negative në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore/artistike, si: largimi i stafit me eksperiencë hulumtuese shkencore nga Universiteti i Prishtinës, kriza ekonomike globale, konkurrencë e fortë për fonde ndërkombëtare (EU, etj), largimi i personelit të ri dhe me perspektivë nga Universiteti i Prishtinës, etj.

2.2. Infrastruktura

Si një institucion i madh i përbërë nga 16 njësi akademike, Universiteti i Prishtinës mbulon shumë fusha kërkimore me laboratorë dhe pajisje që ofrojnë mundësi të mirë për kërkime ndërdisiplinare. Sipas raportit të vetëvlerësimit të Universitetit të Prishtinës, totali i sipërfaqes së laboratorëve është 11,520 m², derisa 1,265 m² është sipërfaqja e përgjithshme e bibliotekave. Laboratorët ekzistues janë pasuruar me pajisje përmes programeve të BE si TEMPUS, kontributeve të USAID, ADA-WUS, etj, por kryesisht shfrytëzohen për pjesën praktike të mësimdhënies.

Megjithatë, cilësia e pajisjeve, sipërfaqja në dispozicion dhe shfrytëzimi i tyre duket se do të jetë njëra nga çështjet më komplekse në vitet në vijim. Vështirësi serioze paraqet hapësira e kufizuar fizike për hulumtime shkencore në shumicën e njësisive akademike dhe mungesa e pajisjeve. Po ashtu, një pjesë e infrastrukturës është vjetruar ose është jashtë funksionit. Vërehet edhe një mungesë e theksuar e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të njësisive akademike në shfrytëzimin e përbashkët dhe racional të hapësirës dhe pajisjeve në dispozicion.

Mungesa e fondeve për infrastrukturë dhe pjesëmarrja e kufizuar në projekte ndërkombëtare hulumtuese me kapacitet ekzistuese kërkimore dhe mosshfrytëzimi ose shfrytëzimi i kufizuar i një pjese të infrastrukturës moderne (për shkak të mos-trajnitimit adekuat për përdorimin e kësaj teknologjie), për kërkime shkencore dhe shërbime janë një grup tjetër i mangësive. Mungon edhe shfrytëzimi/komercializimi i infrastrukturës për kërkime dhe shërbime të kontraktuara. Nuk shfrytëzohen në masë të duhur as kapacitetet e institucioneve të tjera që nuk janë njësi organizative të Universitetit të Prishtinës: Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, Qendrës Klinike Universitare, Institutit Albanologjik, Institutit të Historisë dhe instituteve tjera ekzistuese.

Universiteti i Prishtinës ka mundësi që duhet shfrytëzuar për t'u përballë me gjendjen aktuale të infrastrukturës duke shtuar pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe ato të financuara nga Fondi Kosovar për Kërkime Shkencore. Në këtë drejtim, duhet shfrytëzuar edhe fondet e parapara për rritjen dhe modernizimin e hapësirës për kërkime shkencore sipas Planit për Zhvillimin e Arsimit 2011-2016 dhe Programit Kombëtar të Shkencës 2010-2015. Në Programin Kombëtar të Shkencës, në kuadër të objektivit "Zhvillimi i Infrastrukturës Kërkimore", është paraparë përkrahje financiare për projekte infrastrukture për periudhën

Disa nga sfidat

- Hapësira e pamjaftueshme fizike, infrastruktura jofunkionale dhe pajisje të vjetruara;
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm në mes të njësisive akademike në shfrytëzimin e përbashkët të hapësirës dhe pajisjeve në dispozicion dhe komercializimi i kufizuar infrastrukturës për kërkime shkencore dhe shërbime të kontraktuara;
- Mosshfrytëzimi dhe shfrytëzimi i kufizuar i një pjese të infrastrukturës moderne (për shkak të mos-trajnitimit adekuat të stafit për përdorimin e kësaj teknologjie) për kërkime shkencore dhe shërbime;
- Koordinimi i mangët për qasje në shfrytëzimin e kapaciteteve jashtë Universitetit të Prishtinës, si: BKU, QKUK dhe instituteve kërkimore – shkencore ekzistuese.

2010-2012 në total 2.5 mil. Euro (për pajisje të laboratorëve, themelim të “Qendrave të Ekselencës” qasje në biblioteka elektronike etj.). Edhe në Planin Strategjik për Zhvillimin e Arsimit 2011-2016 janë paraparë fonde për infrastrukturë. Një mundësi tjetër është edhe shfrytëzimi me i mirë i kapaciteteve infrastrukturore për bashkëpunim me sektorin e biznesit në kuadër të projekteve zhvillimore dhe shërbimeve të kontraktuara të orientuara kah kërkesat e tregut.

Megjithëse mundësitë duken të jenë reale, Universiteti i Prishtinës mund të ballafaqohet me mungesë interesimi nga ana e institucioneve tjera kërkimore shkencore dhe sektorit të biznesit për projekte hulumtuese dhe zhvillimore që mbështeten në kapacitetet infrastrukturore të tij por edhe me ngecje në zbatim të fondit për kërkime shkencore të paraparë me Programin Kombëtar të Shkencës. Kjo e fundit është veçmas brengosëse për faktin se nga mjetet e parapara për infrastrukturë në vitin 2010 janë shpenzuar vetëm rreth 70,000 Euro për qasje në “ISI Web of Knowledge” ndërsa në vitet 2011 dhe 2012, MASHT, ka financuar edhe projekte kërkimore prej të cilave ka përfituar UP.

2.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Universiteti i Prishtinës ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve akademike dhe kërkimore nga vendet tjera të botës dhe të rajonit, disa prej të cilave kanë rezultuar me projekte të përbashkëta të suksesshme. Kështu, mund të përmendim Universiteti teknik “Middle East” në Ankara të Turqisë, Universiteti i Oslos në Norvegji dhe Universiteti i Lubjanës në Slloveni me të cilat janë realizuar mobilitete të studenteve në nivelin master dhe studime të doktoratës. Përveç kësaj, institucionet tjera me të cilat ekziston bashkëpunim më i afërt janë: Universiteti i Zagrebit në Kroaci, Universiteti Heidelberg në Gjermani, Universiteti i Grazit në Austri, Universiteti Katolik i Leuven-it në Belgjikë, etj.

Duhet përmendur faktin se bashkëpunimi ndërkombëtar, në shumë raste, zhvillohet në bazë të nismave dhe raporteve individuale të personelit akademik dhe të grupeve hulumtuese me partnerët përkatës nga institucione të tjera. Raportet e tilla, me gjithë se jo formale, shpesh kanë rezultuar me realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe përfshirje më të gjerë të personelit në ndërmarrje të tilla.

Në vitet akademike 2010/11 dhe 2011/12 Universiteti i Prishtinës ka ndarë një shumë prej 150,000 EUR për nxitjen e mobilitetit të personelit akademik në vendet e BE-së, me qëllim të avancimit të kërkimeve dhe të mësimdhënies. Kanë qenë 20 anëtarë të personelit akademik që kanë përfituar bursa për qëndrim hulumtues jashtë vendit në kohëzgjatje të përgjithshme prej 80 muaj. Kjo ka qenë një nismë shumë pozitive e cila ka bërë të mundur publikimin e disa punimeve shkencore në revista me recension të pranuar ndërkombëtar dhe ka rezultuar me ndërtimin e raporteve të reja me kolegë

Disa nga sfidat

- Mungesa e të dhënave të sistemuara për projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Kapaciteti i pamajftueshëm për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore të karakterit ndërkombëtar;
- Vështirësi objektive dhe administrative për bashkëfinancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës.

nga institucionet pritëse që potencialisht mund të rezultojnë me thellim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit dhe ngritjen e tij në nivel të partneritetit institucional. Përveç kësaj, Universiteti i Prishtinës ofron mbështetje për pjesëmarrje të personelit mësues në simpoziume, qëndrime studimore dhe ngjarje të tjera shkencore dhe artistike.

Në kohën e finalizimit të kësaj strategjie, janë duke u evidentuar dhe sistemuar të dhënat për projektet dhe format tjera të bashkëpunimit. Disa herë janë bërë përpjekje që të dhëna të tilla të sigurohen, por njësitë akademike nuk kanë treguar shumë zell për dërgimin e tyre. Në kushte të tilla është vështirë të merren vendime të informuara për avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës.

Kapaciteti për planifikimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore të karakterit ndërkombëtar mbetet mjaft i kufizuar. Përveç shkathësive teknike në përgatitjen e aplikacioneve, kërkohet edhe angazhim mjaft i madh për sigurimin e dokumentacionit mbështetës të aplikacionit, i cili mungon. Të shumtën e rasteve, ndodhë që temën e kërkimeve e përcakton institucioni partner nga vendi tjetër, ndërkaq roli i Universitetit të Prishtinës reduktohet në ofrimin e të dhënave relevante dhe të dokumentacionit mbështetës. Një qasje e tillë ndikon negativisht në krijimin e ndjenjës së mirëfilltë të pronësisë, si dhe në angazhimin e personelit vendor në fazën e zbatimit. Vet zbatimi i projekteve kërkimore paraqet një sfidë, pasi në Universitet nuk funksionojnë si duhet, ose mungojnë fare, strukturat e nevojshme mbështetëse. Kështu, fondet e projekteve menaxhohen në bazë të procedurave rigjide administrative dhe financiare që ngadalëson ose edhe bën të pamundur shpërndarjen e tyre për qëllime për të cilat janë dedikuar.

Përveç në raste të rralla, tenderët ndërkombëtarë për projekte kërkimore janë të karakterit global dhe vënë në plan të parë cilësinë, gjë që paraqet një sfidë tjetër për Universitetin. Për të përmbushur kërkesat e tilla, Universiteti duhet të lidhë partneritet me institucione prestigjioze kërkimore nga vendet tjera të botës, të cilat edhe përcaktojnë agjendën dhe shkallën e përfshirjes së Universitetit. Problemi qëndron në faktin se nuk janë ndërtuar partneritete të qëndrueshme me institucione prestigjioze që do të hapnin rrugë për vendosjen e një komunikimi të përhershëm në mes të Universitetit të Prishtinës dhe partnerëve të tij në fushën e kërkimeve shkencore/artistike, por këto partneritete ndërtohen prej rastit në rast për të përmbushur kërkesat e një tenderi. Ndërkaq, në fushën e avancimit të mësimdhënies, bashkëpunimi është diç më i mirë.

Projektet kërkimore ndërkombëtare rëndom nisen nga supozimi që institucioni përfitues bashkë-financon shpenzimet e kërkimit. Në rastin e Universitetit të Prishtinës situata paraqitet më e ndërlikuar për të paktën dy arsye. E para, personeli akademik nuk ka obligime kontraktuese për të bërë kërkime, por për të mbajtur numër të caktuar të orëve të mësimin, prandaj Universiteti nuk mund ta shfrytëzojë kohën e personelit si kontribut të vetin. Nga ana tjetër, mundësitë për kontribute financiare janë më se të kufizuara për shkak të buxhetit të kufizuar të Universitetit dhe mos-ndarjes së mjeteve financiare për kërkime.

Kohëve të fundit vërehet një shkallë e lartë e gatishmërisë për përfshirje më të madhe të institucioneve nga Kosova në projekte kërkimore të karakterit ndërkombëtar. Fillimisht vlen të përmendet se Kosova ka statusin e vendit partner në programin e Komisionit Evropian FP7, ndërsa me insistimin e Komisionit Evropian, MASHT ka emëruar edhe pikën e kontaktit për këtë program. Deri me tani Universiteti i Prishtinës është partner në një projekt FP7 i cili zhvillohet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nga tetori të vitit 2011. Në fillim të vitit 2012 UP ka përfituar tri projekte kërkimore nga programi i përkrahjes të Komisionit Evropian

për ndërtim kapacitetesh në fushën e kërkimeve, dy prej tyre në cilësinë e koordinatorit dhe një në cilësinë e partnerit. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është 661,104 EUR.

Po ashtu, edhe agjenci të tjera ofrojnë mundësi për financimin e projekteve kërkimore. Kështu, Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (DEZA) ofron projekte bashkëpunimi me vendet e Evropës Lindore. Kjo agjenci synon të nxisë pavarësinë ekonomike për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të prodhimit, përmirësimin e kushteve të mjedisit, për të ofruar qasje me të mire në arsimim, kujdes shëndetësor, etj.

Ndërsa, Zyra Austriake për Shkencë (ASO) në kuadër të projektit KAIP ka financuar 10 projekte të vogla kërkimore ku është përfshirë Universiteti i Prishtinës. Ka filluar edhe faza e dytë e partneritetit Kosovë-Austri në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës (HigherKOS) që është duke ofruar mundësi të reja për financimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës në fushën e kërkimeve, bursave për studime të doktoratës dhe post-doktoratës, etj..

Me gjithë faktin se Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Programin Kombëtar të Shkencës për periudhën 2010-2015, në vitin 2010 janë shpenzuar 100,000 EUR nga 1 mil. EUR të planifikuara, ndërsa për vitin 2011 janë ndarë 400,000 EUR nga linjat buxhetore të MASHT, me gjithë faktin se programi parasheh shumë prej 2.4 mil. EUR. Ndërkaq, në vitin 2012 janë ndarë 484,920 EUR nga 3.5 mil EUR sa janë planifikuar. Nga ana tjetër, Kosova ndodhet në situatën që kërkon financimin e pjesës më të madhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore nga buxheti i shtetit deri në momentin kur sektori privat e sheh interesin e vet për të marrë rol në këtë lëmi.

Një pjesë e madhe e stafit akademik nga Kosova që punojnë në vende të ndryshme të botës kanë treguar interesim që të kontribuojnë në procesin mësimor në Universitetin e Prishtinës përmes programeve të tipit “Kthimi i trurit”. Mirëpo, përvoja ka treguar se gatishmëria e tillë në fushën e kërkimeve shkencore/artistike nuk ekziston ose është dukshëm më e vogël. Sa për ilustrim, në konkursin e MASHT, të publikuar në tetorin e vitit 2010 që i dedikohet kësaj kategorie të hulumtuesve, nuk është paraqitur asnjë kandidat.

2.4. Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë

Vendosja e lidhjeve në mes të ekonomisë dhe institucioneve akademike – në funksion të bashkëpunimit në fushën kërkimore-shkencore dhe me qëllim final zhvillimin mbarëshoqëror - është sfidë për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Sipas “Raportit të Vetëvlerësimit të Universitetit të Prishtinës”, momentalisht ekziston bashkëpunim – edhe pse i kufizuar – me përfaqësues të ekonomisë përmes këshillave drejtuese në shumë projekte në Universitet. Shembull reprezentativ i këtij bashkëpunimi është “Bordi Industrial” i krijuar në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) që përbëhet nga përfaqësues të kompanive kryesore publike në Kosovë si: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta e Kosovës (PTK), Aeroporti i Prishtinës (ANP) etj.

Një ndër dobësitë kryesore që e ka karakterizuar Universitetin e Prishtinës deri vonë ishte qasja e njohur si: “qëndro larg biznesit”. Kjo dukuri nuk mundëson krijimin e baraspeshës në mes të ofertës së programeve mësimore nga Universiteti i Prishtinës dhe kërkesës së tregut. Konstatimi i njëjtë evidentohet edhe në “Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë (2005-2015)”.

Dobësi tjetër është edhe fakti se Universiteti i Prishtinës nuk ka arritur që, në masë të duhur dhe në mënyrë institucionale, të përfshijë palët me interes nga ekonomia dhe shoqëria në hartimin e kurrikulave për studimet pasuniversitare (master dhe të doktoratës). Edhe pse ekzistojnë iniciativa në disa prej njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e programeve në konsultim të ngushtë me palët e interesit, një praktikë e tillë ende nuk është e formalizuar, gjë që ndikon në masë domethënëse që dija që ofrohet në studime të mos jetë në përputhshmëri me kërkesat dhe nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë. Universiteti i Prishtinës është në proces të zhvillimit të kurrikulave që ofrojnë ndërlidhje më të mirë me tregun e punës, konform përvojave të universiteteve më të mira evropiane.

Nuk ekziston bashkëpunim i mjaftueshëm me ekonominë dhe me industrinë, sidomos përmes partneritetit publiko-privat, për gjenerimin e fondeve për kërkim dhe zhvillim. Konkretisht, Universiteti i Prishtinës nuk ka lidhur marrëveshje që do të mundësonin bashkëpunimin dhe aplikimin e përbashkët me sektorin e ekonomisë në fonde kërkimore-shkencore dhe zhvillimore. Përveç kësaj, dobësi tjetër e theksuar është edhe mosekzistimi i mundësive të institucionalizuara në kuadër të Universitetit të Prishtinës për kryerjen e praktikës përmes së cilëve do t’ju mundësohet kandidatëve në nivelin pasdiplomik –master dhe të doktoratës – që një pjesë të hulumtimeve të tyre t’i zhvillojnë nëpër kompani.

Si reagim ndaj sfidave të reja me të cilat përballlet, Universiteti i Prishtinës ka treguar vullnet për të ndryshuar. Një përkushtim i tillë shihet si mundësi dhe potencial edhe nga “Raporti i Vetëvlerësimit të Universitetit të Prishtinës”. Sipas këtij raporti, Universiteti i Prishtinës është i përkushtuar që të vazhdojë zhvillimin e vet në të ardhmen, në mënyrë që të jetë i suksesshëm në misionin e vet për të ofruar arsimim cilësor që bazohet në hulumtime shkencore/artistike që i shërbejnë nevojave të studentëve, ekonomisë dhe shoqërisë në një formë më fleksibile.

Edhe pse momentalisht marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të institucioneve nga sektori i ekonomisë dhe Universitetit të Prishtinës ekzistojnë vetëm në formë sporadike, është vërejtur interesim i palëve me interes për të marrë pjesë në dizajnimin e plan programeve dhe projekteve kërkimore dhe zhvillimore (p.sh. bashkëpunimi i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me STIKK për zhvillimin e kurrikulit për student). Një gjë e tillë mund të

Disa nga sfidat

- Mungesë e projekteve kërkimore dhe zhvillimore në bashkëpunim me sektorin e biznesit dhe mungesë e mundësive për kryerjen e praktikës hulumtuese;
- Ofertë e limituar e shërbimeve për ekonominë;
- Ndikim i kufizuar i rezultateve të punës kërkimore-shkencore në politikbërje, zhvillim dhe rrjedha shoqërore;
- Përfshirje e pamjaftueshme e palëve me interes nga ekonomia dhe shoqëria në hartimin e kurrikulave për studime pasuniversitare.

realizohet përmes organizimit të evenimenteve të ndryshme së bashku me palët me interes për identifikimin e fushave me interes të përbashkët, dizajnimin e kurrikulës dhe projekteve kërkimore.

Nga ana tjetër, përkushtimi i stafit aktual të Universitetit të Prishtinës për t'u angazhuar në projekte bashkëpunuese në mes të ekonomisë dhe Universitetit të Prishtinës është mjaft i mangët. Një hezitim i tillë shkaktohet, ndër të tjera, edhe nga mungesa e stimulimit adekuat por edhe nga mungesa e mekanizmave dhe instrumenteve adekuate që do t'i obligonin stafin që të angazhohen më shumë në kërkime shkencore/artistike dhe zhvillimore. Aktualisht ekziston vetëm bashkëpunim individual (ose në kuadër të institucioneve tjera) i stafit të Universitetit të Prishtinës në projekte kërkimore dhe zhvillimore, apo edhe atyre konsulente.

3. Objektivat, masat dhe rezultatet e pritshme

Për secilën nga katër fushat ku është analizuar gjendja, është formuluar nga një objektiv zhvillimor:

Objektivi 1: Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës.

Objektivi 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe për ofrimin e shërbimeve.

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Objektivat përcaktojnë caqet e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në periudhën vijuese katërvjeçare. Për secilin objektivë janë përcaktuar masat e nevojshme për arritjen e tij. Ndërsa, për çdo masë janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

3.1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Cilësia e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike varet nga disponueshmëria e personelit të mirë-aftësuar dhe të motivuar për t'u marr me këtë veprimtari. Kjo sfidë duhet të plotësohet duke i nxitur kapacitetet njerëzore brenda Universitetit të Prishtinës të avancojnë në karrierën e tyre akademike, duke avancuar kështu veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike në përgjithësi. Universiteti i Prishtinës është i vetëdijshëm se kërkimi-shkencor/artistik dhe zhvillimi janë pjesë e sistemit të arsimit të lartë dhe se janë me rëndësi jetike për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.

Duke marr parasysh se në dy dekadat e fundit në Universitetin e Prishtinës ka munguar një sistem stimulues i avancimit të personelit bazuar në rezultatet nga veprimtaria kërkimore-shkencor/artistike dhe zhvillimore, ky institucion do të angazhohet për stimulimin e kuadrit që merret aktivisht me veprimtari të tillë në të gjitha disiplinat. Nga ana tjetër, ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe angazhimi i tyre në punë hulumtuese do të rezultojë me sigurimin e fondeve brenda Universitetit të Prishtinës, me të cilat fonde do të mund të kontribuohet në avancimin e

kërkimit shkencor/artistik, varësisht nga nevoja. Kjo e fundit kërkon nga Universiteti të ndërtojë bazën ligjore e cila përcakton format e angazhimit të stafit të Universitetit të Prishtinës në veprimtari kërkimore–shkencore/artistike brenda dhe jashtë tij.

Objektivi 1: Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës.

Masat dhe rezultatet e pritshme:

Masa 1.1:	Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës bazuar në sistemin e Bolonjës.
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do të vazhdoj të zhvillojë programe të doktoratës duke u bazuar në Rregulloren e Universitetit të Prishtinës për studimet e doktoratës. Duke pasur parasysh se Universiteti i Prishtinës, momentalisht, është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë i cili ofron studime të doktoratës , programet e hartuara për disipinat me prioritet për vendin dhe ato që përfundojnë me dhënien e thirrjes së dyfishtë do të kenë prioritet.</p> <p>Universiteti i Prishtinës në veçanti do të inkurajojë njësitë akademike për zhvillimin e programeve të doktoratës të cilat do të zhvillohen në bashkëpunim me institucione të mirënjohura të arsimit të lartë dhe të shkencës nga vende të tjera. Universiteti i Prishtinës do të përkrah aplikimin për fonde që sigurojnë praninë e shtuar të komponentës kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore në programet e doktoratës.</p> <p>Mënyra më e mirë për sigurimin e cilësisë të programeve të ndryshme në studimet e doktoratës është implementimi në përpikëri i rregullores për studimet e doktoratës e cila është në fuqi nga viti 2011.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>1.1.1. Në përputhje me Rregulloren, çdo vit Universiteti i Prishtinës do të përkrahë zhvillimin e së paku 5 programeve të studimeve të doktoratës në disiplina të ndryshme.</p> <p>1.1.2. Në përputhje me Rregulloren, çdo vit Universiteti i Prishtinës do të përkrahë zhvillimin e së paku 1 programi ndërdisiplinor dhe me prioritet të studimeve të doktoratës.</p> <p>1.1.3. Çdo vit Universiteti i Prishtinës do të përkrahë regjistrimin e së paku 80 studentëve të rinj në studimet e doktoratës.</p>

Masa 1.2:	Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do të ofroj mbështetje për mobilitet afatshkurtër të hulumtuesve nga Universiteti i Prishtinës në institucionet e vendeve të zhvilluara. Për të realizuar këtë aktivitet, Universiteti i Prishtinës do të zhvillojë procedura që rrisin cilësinë dhe konkurrencën e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike si: zhvillimi i kriterëve për përzgjedhjen e</p>

	<p>përfituesve, informimi dhe shpallja publike me kohë lidhur me këtë mundësi, ndihmë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e qëndrimit afatshkurtër të personelit akademik jashtë vendit. Aktiviteti i tillë duhet të çojë në botime dhe/ose krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucionit vendës dhe atij mikpritës.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>1.2.1. Çdo vit akademik Universiteti i Prishtinës mbështet financiarisht së paku 20 mobilitete afatshkurtra për hulumtuesit më aktivë të Universitetit të Prishtinës.</p> <p>1.2.2 Përgatitet dokumentacioni i nevojshëm dhe procedurat lidhur me qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.</p>

Masa 1.3:	Nxitet qasja ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike.
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do të favorizojë projektet me qasje ndërdisiplinore dhe me prioritet të cilat ngërthejnë në vete aktivitete kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore për përmbushjen e nevojave të vendit. Me prioritet të veçantë do të jenë projektet kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore të cilat realizohen përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.</p> <p>Me qëllim të fuqizimit të punës ekipore dhe shfrytëzimit racional të personelit akademik dhe infrastrukturës ekzistuese, Universiteti i Prishtinës do të nxisë komunikimin (veprimtarinë) kërkimor-shkencor/artistik dhe zhvillimor i cili promovon bashkëpunim brenda dhe në mes të njësisve akademike të Universitetit të Prishtinës.</p> <p>Për këtë çështje, Universiteti i Prishtinës së bashku me menaxhmentin e njësisve akademike do të sigurojnë marrëveshje kontraktuale për personelin e angazhuar në projekte të tilla.</p>
Rezultatet e pritshme:	1.3.1. Së paku 20% e fondeve te parapara për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike do të shpenzohen për projekte ndërdisiplinore.

Masa 1.4:	Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore-shkencore/artistike.
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do zhvillojë kriteret për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimore-shkencore/artistike. Këto kriteret duhet të përfshijnë: numrin dhe vlerën e projekteve shkencore të realizuara, numrin e publikimeve shkencore, rangimin e punimeve shkencore bazuar në standardet vlerësuese botërore (faktori i impaktit, faktori “H”, etj.), lehtësime të veçanta kontraktuale për pjesëmarrje në programet kërkimore-shkencore/artistike (pas-doktoratë, hulumtime të shkurtra në qendrat e përsosmërisë në të gjithë botën, etj.). Mbështetja do të synojë përfshirjen e hulumtuesve në fushat prioritare dhe ndërdisiplinore, në fushat ku ka mungesë të hulumtuesve në Universitetin e Prishtinës dhe përkrahjen e të rinjve që janë të përkushtuar për të kontribuar në</p>

	<p>zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve hulumtuese në Universitetin e Prishtinës. Me qenë se raporti gjinor mes stafit akademik është në disfavor të gjinisë femërore (afërsisht 28.5% femra), Universiteti i Prishtinës një vëmendje të posaçme do t'i kushtoj pjesëmarrjes së tyre në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore.</p> <p>Hapi i parë do të jetë krijimi i kornizës ligjore e cila do të rregulloj këto forma stimuluuese. Me qëllim të nxitjes, personeli akademik dhe hulumtuesit e Universitetit të Prishtinës do të informohen me kohë për mundësitë e ndryshme.</p>
Rezultatet e pritshme:	1.4.1 Miratimi i rregullores për stimulim të personelit të përfshirë në punë kërkimore-shkencore/artistike.

Masa 1.5:	Nxitet përfshirja e kapaciteteve nga diaspora në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore.
Përshkrimi:	<p>Gjatë dekadave të fundit, ekziston një numër i konsiderueshëm i hulumtuesve me origjinë nga Kosova të cilët kanë emigruar gjithandej në botë. Disa nga ta kanë pasur mundësi që të angazhohen në institucione hulumtuese shkencore me renome, të cilën veprimtari e kryejnë edhe sot. Angazhimi i tyre, si bashkëpunëtorë apo zbatues të programeve kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore, do të kishte rëndësi të veçantë për Universitetin e Prishtinës .</p> <p>Për këtë qëllim, Universiteti i Prishtinës do të zhvilloj kontakte të drejtpërdrejta dhe do të krijoj bazën e të dhënave për hulumtuesit kosovarë nga diaspora që plotësojnë kriteret e caktuara akademike dhe shkencore.</p> <p>Universiteti i Prishtinës, i vetëdijshëm për rëndësinë që ka përvoja dhe angazhimi i hulumtuesve nga diaspora në fuqizimin, ndërkombëtarizimin dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, do të përkrahë këtë aktivitet përmes ofrimit të infrastrukturës ekzistuese (zyrë, kompjuterë, laborator, etj.) dhe akomodimin e tyre gjatë periudhës së angazhimit në këto aktivitete.</p> <p>Njësia për mbështetje veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës do të ndihmoj komunikimin me hulumtues kosovarë nga diaspora duke siguruar informacion për pjesëmarrje në projekte të ndryshme dhe duke krijuar kontakte me hulumtuesit nga Universiteti i Prishtinës (e-mail, web faqen e Universitetit të Prishtinës, kontakte të drejtpërdrejta etj.).</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>1.5.1. Identifikimi dhe krijimi i kontakteve me hulumtuesit nga diaspora.</p> <p>1.5.2. Përkrahje për hulumtuesit Kosovar nga diaspora gjatë angazhimeve të tyre në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore në Universitetin e Prishtinës (zyrë, akomodim, etj.).</p>

Masa 1.6:	Përcaktohen obligimet kontraktuale për kontribut në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike për personelin akademik.
Përshkrimi:	Angazhimi i kontraktuar në mes të Universitetit të Prishtinës dhe personelit akademik kryesisht përfshinë obligimet e tyre të përcaktuara për mësimdhënie, derisa veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike tentohet të promovohet dhe

	realizohet në kuadër të këtij konteksti. Një qasje e tillë është duke e penguar mbarëvajtjen e reformave në këtë institucion dhe lidhshmërinë e mësimdhënies me punën shkencore brenda Universitetit të Prishtinës . Universiteti i Prishtinës do krijojë rregullativën për angazhimin e personelit të Universitetit të Prishtinës në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore-shkencore/artistike bazuar në praktikën më të mira evropiane.
Rezultatet e pritshme:	1.6.1. Krijimi i rregullativës për angazhimin e personelit të Universitetit të Prishtinës bazuar në praktikën e mira evropiane.

3.2. *Funksionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës*

Duke marrë në konsideratë se infrastruktura përcakton në masë të madhe edhe përmbushjen e synimeve për avancimin e punës kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore, duhet të ndërmerren masat që përkrahin përmirësimin e gjendjes në infrastrukturë fizike, pajisje, TIK, etj. Universiteti i Prishtinës do të ofrojë parakushte për shfrytëzim maksimal të infrastrukturës ekzistuese, por edhe fonde për përtëritjen e pajisjeve dhe modernizimin e rrjetit të laboratorëve dhe bibliotekave në mënyrë që të jetë sa më konkurrues në garën për fonde për hulumtime brenda dhe jashtë vendit.

Për këtë qëllim, Universiteti i Prishtinës fillimisht do të promovojë kapacitetet infrastrukturore kërkimore-shkencore/artistike për të "joshur" sektorin e biznesit për bashkëpunim; të rregullojë shfrytëzimin e përbashkët (të koordinuar) në mes të njësive; të funksionalizoj infrastrukturën e pashfrytëzuar; të trajtojë personelin për shfrytëzimin e aparaturës moderne që aktualisht nuk shfrytëzohet; të shfrytëzojë kapacitetet për të ofruar kërkime dhe shërbime të kontraktuara me qëllim komercializimi dhe për të shfrytëzuar këto fonde për përmirësim të infrastrukturës. Po ashtu, Universiteti i Prishtinës do të promovojë interesin reciprok të qasjes në Bibliotekën Kombëtare, Qendrën Klinike Universitare, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë dhe Institutet tjera kërkimore-shkencore dhe zhvillimore si dhe të sensibilizojë e motivojë stafin e Universitetit të Prishtinës për aplikim në fonde brenda dhe jashtë vendit.

Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve infrastrukturore ekzistuese, trajnimi i stafit për përdorimin e infrastrukturës moderne, krijimi i parakushteve optimale për mirëmbajtjen e saj, si dhe shfrytëzimin në mënyrë inteligjente dhe inovative të kapaciteteve aktuale infrastrukturore për kërkime dhe shërbime të kontraktuara me qëllim komercializimi, janë parakushte për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme.

Objektivi 2: Funksionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe për ofrimin e shërbimeve

Masat dhe rezultatet e pritshme

Masa 2.1:	Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitetin e Prishtinës
Përshkrimi:	Universiteti i Prishtinës, gjegjësisht Njësia për përkrahjen e kërkimeve shkencore, fillimisht do të bëjë inventarizimin e infrastrukturës aktuale për kërkime shkencore dhe shërbime për të konstatuar gjendjen ekzistuese dhe shkallën e shfrytëzimit të asaj infrastrukture. Kjo do të bëhet duke angazhuar një panel prej 4-5 ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët do përgatisin

	<p>një raport për gjendjen e konstatuar të infrastrukturës dhe rekomandimet për shfrytëzim sa me efikas dhe inovativ të këtyre kapaciteteve.</p> <p>Informacioni nga ky raport do të publikohet edhe në faqen elektronike të Universitetit të Prishtinës dhe do t'u komunikohet palëve të interesuara në forma të ndryshme: postë elektronike, takime të drejtpërdrejta, përmes broshurave etj.</p>
Rezultatet e pritshme:	2.1.1. Raporti i studimit dhe informata për kapacitetet infrastrukturore të Universitetit të Prishtinës.

Masa 2.2:	Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të Universitetit të Prishtinës
Përshkrimi:	Duke u bazuar në raportin e ekspertëve dhe rekomandimet e tyre për kapacitetet infrastrukturore dhe gjendjen e saj, grupi këshillëdhënës për kërkime shkencore në bashkëpunim me Njësinë për kërkime shkencore do të hartojë rregullore për përdorimin e përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të Universitetit të Prishtinës.
Rezultatet e pritshme:	2.2.1. Miratimi i rregullores përkatëse.

Masa 2.3:	Lidhen marrëveshje për shfrytëzim të infrastrukturës kërkimore të institucioneve të tjera në vend dhe jashtë
Përshkrimi:	Qëllimi i këtij aktiviteti është që, në kuadër të marrëveshjeve për bashkëpunim në projekte, t'i kushtohet vëmendje e veçantë definimit të mundësive të shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës kërkimore si dhe qasjes në infrastrukturës moderne të institucioneve tjera (institutet kërkimore brenda vendit si dhe institucionet kërkimore jashtë vendit).
Rezultatet e pritshme:	2.3.1. Marrëveshjet për shfrytëzim të kapaciteteve partnerëve jashtë-universitarë: të QKUK, BKUK, Institutit Albanologjik, Institutit të Historisë, Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit, Arkivi i Kosovës dhe Instituteve tjera. 2.3.2. Identifikimi i partnerëve strategjikë të jashtëm dhe lidhja e marrëveshjeve për shfrytëzim të infrastrukturës moderne të tyre.

Masa 2.4:	Themelohen/Funksionalizohen laboratorë dhe institute dhe pajisen me infrastrukturë përkatëse
Përshkrimi:	Grupi këshillëdhënës për kërkime shkencore në bashkëpunim me Njësinë për kërkime, do të hartojë një master-plan për të riaktivizuar dhe/ose ristrukturuar pjesën e pashfrytëzuar të infrastrukturës si dhe për themelimin e instituteve të reja (qendrave të ekselencës), përfshirë riaktivizimin e disa instituteve që kanë pushuar së vepruari.

	<p>Njësia për kërkime shkencore, në bashkëpunim me njësitë akademike, do të përgatisë projekt-propozime për fonde të infrastrukturës kërkimore, qoftë për të funksionalizuar, ristrukturuar ose modernizuar laboratorët aktual apo duke themeluar laborator/institute/qendra të ekselencës.</p> <p>Universiteti i Prishtinës do të themelojë edhe fondin e veçantë për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe blerje të pajisjeve kyçe dhe me përdorim të gjerë, si dhe për trajnimin e stafit për përdorimin e tyre.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>2.4.1. master-plani i zhvilluar.</p> <p>2.4.2. Së paku 1% e buxhetit të Universitetit të Prishtinës ndahet për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe për pajisje të reja.</p> <p>2.4.3. Së paku 5 qendra të ekselencës (institute kërkimore shkencore) të parapara me Programin Kombëtar të Shkencës themelohen në Universitetin e Prishtinës.</p> <p>2.4.4. Aftësohet stafi i Universitetit të Prishtinës për përdorimin e pajisjeve kyçe dhe me përdorim të gjerë.</p>

Masa 2.5:	Sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante
Përshkrimi:	Do të ofrohet qasje në biblioteka elektronike, si dhe në resurse on-line të partnereve strategjik.
Rezultatet e pritshme:	2.5.2. Qasjet në së paku dy platforma elektronike.

3.3. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë

Veprimtaria kërkimore-shkencore nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar dhe pavarësisht nga zhvillimet në rrafshin ndërkombëtar. Kosova, si vend i vogël, ka pak mundësi për të financuar kërkime specifike që mund të zhvillohen pa bashkëpunim ndërkombëtar. Nga ana tjetër, burimet kryesore të financimit për punë kërkimore-shkencore/artistike vijnë nga fondet e BE-së ku zhvillimi i raporteve bashkëpunuese me institucione simotra jashtë vendit paraqitet si domosdoshmëri.

Universiteti i Prishtinës do ta inkurajojë partneritetin e njësive akademike të tij, të grupeve hulumtuese dhe të individëve me nivele përkatëse të organizimit në vende të tjera. Përveç ndërtimit të kapacitetit për një bashkëpunim të tillë, Universiteti ka për detyrë të ndërtojë kornizën e bashkëpunimit, duke lidhur partneritetet institucional me universitete të tjera dhe institute kërkimore jashtë vendit.

Në këtë përpjekje për ta ndërkombëtarizuar veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike, Universiteti do të ofrojë përkrahje të veçantë për ato njësi akademike, grupe hulumtuese dhe individë që synojnë përsosmërinë në kërkime, sepse, në këtë formë, veprimtaria kërkimore-shkencore/artistike bëhet pjesë e aktivitetit të përditshëm akademik të Universitetit.

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

Masat dhe rezultatet e pritshme

Masa 3.1:	Lidhen partneritete strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do të vazhdojë me zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe me lidhjen e marrëveshjeve të reja, i vetëdijshëm se çdo projekt i përbashkët kërkimor është në funksion të avancimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në vend. Megjithatë, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara për menaxhimin e bashkëpunimit dhe kërkesat që shtrohen me rastin e aplikimit për fonde, Universiteti duhet të përqendrohet në 2-3 institucione nga vendet evropiane dhe të Rajonit me të cilat ka partneritet strategjik për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Manifestimi më i dukshëm i partneriteteve të tilla është aplikimi i përbashkët për fonde kërkimore dhe realizimi i përbashkët i projekteve kërkimore.</p> <p>Mënyra më e mirë për t'i identifikuar këto institucione është realizimi i marrëveshjeve ekzistuese për të parë se cilat prej tyre janë më dobiprurëse për Universitetin. Kjo është një ndër çështjet që duhet të diskutohet me Grupin Këshillëdhënës për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të Universitetit të Prishtinës, duke nxjerrë rekomandimet përkatëse.</p>
Rezultatet e pritshme:	3.1.1. Rekomandimet e Grupit Këshillëdhënës për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të Universitetit të Prishtinës për 2-3 partneret strategjik të Universitetit të Prishtinës.

Masa 3.2:	Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve.
Përshkrimi:	<p>Njësia për veprimtari kërkimore-shkencore do të identifikojë një grup prej 5-7 anëtarësh të personelit akademik të Universitetit që kanë përvojë në hartimin dhe/ose menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të karakterit akademik dhe janë të gatshëm që përvojën e tyre ta vejnë në dispozicion të avancimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitet. Ky grup bërthamë do të trajnohet për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit në fushën e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Për trajnimin e mëtutjeshëm të anëtarëve të grupit bërthamë do të shfrytëzohen projektet ekzistuese të donatorëve.</p> <p>Anëtarët e grupit bërthamë do të jenë në dispozicion për të ofruar asistencë teknike për hartimin e projekteve në bazë të kërkesave të njësive akademike. Ata do të kontraktohen nga Universiteti për çdo rast të veçantë të ofrimit të shërbimeve të tilla dhe do të jenë përgjegjës për lehtësimin e procesit të</p>

	<p>planifikimit, si dhe për hartimin e aplikacioneve. Po ashtu, do t'i ndihmojnë njësitë akademike që t'i përmbushin kërkesat administrative që përcjellin çdo aplikim.</p> <p>Përveç grupit bërthamë, Universiteti do të organizojë trajnime për hartimin e projekteve edhe për personelin akademik në mënyrë që njësitë akademike të krijojnë kapacitete për të planifikuar punën kërkimore-shkencore që zhvillohet brenda tyre. Edhe për këto trajnime do të shfrytëzohet përkrahja e donatorëve, ndërsa personat që tregojnë afinitet për hartimin e projekteve do të përfshihen në grupin bërthamë, në mënyrë që një rreth sa më i gjerë të përfitojë nga përvoja e tyre.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>3.2.1. Grupi bërthamë prej 5-7 persona.</p> <p>3.2.2. Universiteti ofron asistencë teknike për planifikimin e të paktën 5 projekteve kërkimore në vit.</p> <p>3.2.3. Të paktën 3 persona nga çdo njësi akademike trajnohen për hartimin e projekteve kërkimore.</p>

Masa 3.3:	Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare
Përshkrimi:	<p>Universiteti i Prishtinës do të themelojë një fond për bashkëfinancimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare me qëllim të nxitjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike në Universitet dhe në vend. Ideja është që Fondi të krijohet nga të hyrat vetanake dhe buxhetore. Përveç financimit me para të gatshme, do të përkrahen edhe format e financimit “in kind”, duke vënë në dispozicion burimet e Universitetit dhe kohën e punës të personelit akademik. Kjo e fundit kërkon një ristrukturim të kontratave të punës për të paraparë obligimin e personelit akademik për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>3.3.1. Çdo vit Universiteti i Prishtinës ndan së paku 1% të buxhetit të përgjithshëm për të përkrahur zbatimin e projekteve ndërkombëtare.</p>

Masa 3.4:	Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.
Përshkrimi:	<p>Njësia për veprimtari kërkimore-shkencore do të shpërndajë informacionin për mundësi të bashkëpunimit ndërkombëtar në zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike të njësitë akademike, grupet hulumtuese dhe personeli akademik në Universitetin e Prishtinës. Hapi i parë do të jetë krijimi i një liste gjithëpërfshirëse të e-mailave ku do të dërgohen njoftimet dhe materialet e ndryshme. Po ashtu, informacioni do të publikohet edhe në faqen elektronike të Universitetit të Prishtinës dhe do t'u komunikohet palëve të interesuara në takime të drejtpërdrejta. Në bashkëpunim me Zyrën për Informim, së paku katër herë në vit do të përgatitet një letër informative prej 2-4 faqe e cila do t'i kushtohet veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës dhe do të shpërndahet me postë elektronike.</p>
Rezultatet e pritshme:	<p>3.4.1. Informacioni relevant për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar shpërndahet të paktën një herë në tre muaj.</p>

3.4. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat

Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror është sfidë e vazhdueshme për Universitetin e Prishtinës. Në këtë kontekst, Universiteti i Prishtinës duhet të ndryshoj qasjen *vis-a-vis* palëve me interes duke i inkurajuar ato që të marrin pjesë në dizajnimin e kurrikulës më qëllim që të jetë në përputhje me kërkesat e tregut. Përveç kësaj, një bashkëpunim i tillë do t'i mundësonte Universitetit të Prishtinës aplikim të përbashkët në projekte shkencore dhe zhvillimore në funksion të implementimit të PKSH dhe PSAK. Gjithashtu, duhet bërë analizë të nevojave të tregut për profile të caktuara të nivelit pas-diplomik.

Më qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve nga sektori i ekonomisë, shoqërisë me Universitetin e Prishtinës, është e nevojshme mbledhja e të dhënave të sakta për marrëveshjet eventuale ekzistuese të bashkëpunimit dhe krijimi i një baze të të dhënave funksionale. Kjo do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe do të promovonte një qasje bashkëkohore të zhvillimit të universitetit me orientim nga ekonomia me qëllim të zhvillimit mbarë shoqëror.

Në këtë kuadër, Universiteti i Prishtinës është i përkushtuar që të forcoj dhe intensifikoj bashkëpunimin dhe partneritetin në kërkime shkencore me palët tjera me interes, përfshirë industrinë, dhe agjencitë qeveritare. Një partneritet i tillë do të avancoj dukshëm pozitën e Universitetit duke ndikuar zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe politik-bërjen në mënyre konstruktive.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Masat dhe rezultatet e pritshme

Masa 4.1:	Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat.
Përshkrimi:	Universiteti i Prishtinës do të krijoj një bazë të dhënash në të cilën do të prezantohen të gjitha marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe privat të ekonomisë dhe Universitetit të Prishtinës. Kjo bazë e të dhënave duhet të jetë e detajuar në atë masë që, veç tjerash, të specifikoj edhe të gjithë emrat e kompanive dhe fushat e veprimtarisë, gjithashtu. Kjo bazë e të dhënave do të përditësohet me rregull. Publikimi i saj do të bëhet në faqen elektronike të Universitetit të Prishtinës në mënyrë që të jetë në dispozicion për të gjithë të interesuarit.
Rezultatet e pritshme:	4.1.1. Zhvillimi dhe publikimi i bazës së të dhënave.

Masa 4.2:	Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkesat e tregut.
Përshkrimi:	Do të zhvillohen mekanizma dhe instrumente për avancimin e bazës ligjore në Universitetin e Prishtinës më qëllim të qartësimit të modaliteteve të bashkëpunimit në mes të institucioneve nga ekonomia e shoqëria dhe Universitetit të Prishtinës. Zhvillimi i këtyre mekanizmave përveç që do të institucionalizonte një qasje të këtillë, do t'i mundësojë Universitetit të Prishtinës që të ofroj programe të certifikuara jo-akademike.
Rezultatet e pritshme:	4.2.1. Zhvillimi i bazës ligjore adekuate ku definohej qartazi të gjithë mekanizmat dhe instrumentet për ofrimin e programeve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut.

Masa 4.3:	Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkime.
Përshkrimi:	Qëllim i Universitetit të Prishtinës është t'u ofrojë studentëve programe akademike cilësore të standardeve të larta perëndimore. Për të arritur këtë, është e nevojshme angazhimi i gjitha njësive akademike të Universitetit të Prishtinës që gjatë zhvillimit të programeve të reja akademike (master dhe të doktoratës) të inkuadrojnë domosdoshmërisht edhe palët e interesit nga fusha e ekonomisë dhe shoqërisë. Mënyra më e mirë për të bërë këtë është mundësimi i njësive akademike që të formojnë borde të veçanta të cilët do të përbëhen nga anëtarë që përfaqësojnë institucione nga ekonomia dhe shoqëria.
Rezultatet e pritshme:	4.3.1. Krijimi i bordeve ekonomike dhe industriale në kuadër të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës.

Masa 4.4:	Angazhohen personeli akademik dhe studentet në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore-shkencore.
Përshkrimi:	Në kuadër të marrëveshjeve që do të realizohen në mes të institucioneve nga sektori publik dhe privat, studentëve të nivelit pasdiplomik (master dhe të doktoratës) do t'i mundësohet që një pjesë të hulumtimeve të tyre ta kryejnë nëpër institucione nga sektori publik dhe privat.
Rezultatet e pritshme:	4.4.1 Institucionalizimi i internshipeve si pjesë e kurrikulit.

4. Menaxhimi

Në komunikatën e Leuvenit të vitit 2009 të ministrave të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL) thuhet: “Arsimi i Lartë i të gjitha niveleve duhet të bazohet në kërkimet shkencore/artistike dhe zhvillimore me të sofistikuar duke kultivuar inovacionin dhe kreativitetin në shoqëri”. Për të realizuar këtë synim, Universitetet duhet të ndërtojnë një sistem efektiv të menaxhimit të aktiviteteve kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore në rend të parë duke vendosur standarde të cilësisë në mësimdhënie e në kërkime shkencore/artistike dhe duke i kushtuar vëmendje lidhjeve në mes të arsimit të lartë dhe kërkimeve shkencore/artistike,

zhvillimit dhe mësimit gjatë gjithë jetës, ashtu siç është konfirmuar në konkluzionet e komunikatave të Bergenit (2005) e të Londrës (2007).

Universiteti i Prishtinës është institucioni më i madh dhe prijës kërkimor-shkencor/artistik në Republikën e Kosovës. Sipas statutit aktual (Kapitulli “Kërkimet shkencore dhe dija”), shprehet obligimi i Universitetit të Prishtinës për të ofruar kushte të përshtatshme për kërkime shkencore dhe për krijimtari artistike dhe t’i mundësojë personelit akademik të arrijë rezultate konkurruese në nivel ndërkombëtar. Po ashtu, parashihet që të gjitha të dhënat për kërkime shkencore dhe punë artistike, duhet të mbliidhen si të dhëna statistikore të standardizuara dhe duhet të ruhen në një bazë qendrore të të dhënave. Prandaj, Universiteti i Prishtinës duhet të përqendrohet në krijimin e kushteve ku mësimdhënia dhe kërkimi shkencor të përfaqësohen në mënyrë të balancuar në strukturën dhe organizimin e tij dhe të sigurojë se stafi me angazhim të plotë të ketë obligime edhe në mësimdhënie e edhe në kërkime.

Me gjithë se qasja e tillë është vlerësuar si bashkëkohore, është konstatim i vazhdueshëm në kuadër të vlerësimeve/raportimeve të ndryshme se ekziston një mungesë e lidhjes dhe baraspeshës së duhur në mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor/artistik në këtë Institucion. Universiteti i Prishtinës ka filluar t’i kushtojë kujdes ndërtimit të një sistemi efektiv që të përkrah në mënyrë adekuate aktivitetet kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore. Hap i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë themelimi i Njesisë për mbështetje të hulumtimeve shkencore (NHSH) e cila, aktualisht, funksionon në kuadër të Zyrës për Zhvillim Akademik (ZZHA). Themelimi dhe funksionimi i kësaj njësie është përkrahur nga projektet: “Themelimi i Zyrës Mbështetëse për Hulumtim Shkencor (RPSO) në Universitetin e Prishtinës”, i financuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës (OSBE) dhe “Krijimi i Kapaciteteve dhe Instrumenteve për Hulumtim dhe Zhvillim dhe për Nxitjen e Bashkëpunimit në Fushën e Arsimit të Lartë dhe Ekonomisë”, i financuar nga programi TEMPUS i Komisionit Evropian.

Aktualisht Universiteti i Prishtinës duhet të përfitojë nga mundësitë që i ka në dispozicion përmes fuqizimit të strukturës dhe rolit të kësaj Njesisë e cila do të bartë aktivitetet për promovimin e kërkimeve-shkencore/artistike, përmbushjen e misionit dhe jetësimin e vizionit për kërkime shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës, organizimin dhe përgatitjen e Universitetit për planifikim të kërkimeve, hartimin e politikave kyçe që kanë të bëjnë me kërkimin, asistimin e hulumtuesve në përgatitjen e projekt-propozimeve, organizimin e punëtorive, si dhe inkurajimin dhe koordinimin e kërkimeve ndërdisiplinare. Kjo Njësi, duhet të ndihmojë dhe menaxhojë marrëdhëniet me agjencitë qeveritare të cilat sigurojnë se Universiteti i Prishtinës është duke përmbushur rolin e tij në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, të ndihmojë apo negocioj për marrëveshje të dimensioneve të mëdha me biznese dhe fondacione që kanë të bëjnë me komercializimin e punës dhe pronësisë intelektuale në kuadër të kërkimeve të sponsorizuara nga ekonomia. Meqë synohet që Universiteti i Prishtinës të jetë me afër kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë, është e nevojshëm që të ngritën edhe kapacitete tjera shtesë të cilat do të bartin këto aktivitete dhe mbanin kontaktet e vazhdueshme me këta sektorë. Në këtë kuadër, Njësia duhet të bartë edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me inovacion, transfer të teknologjisë dhe ndërmarrësi.

Një nga angazhimet me urgjente të kësaj Njesisë do të jetë përpilimi i bazës unike të të dhënave për gjendjen dhe aktivitetet përkatëse (do të ishte me ekonomike që të shfrytëzohen softuerë që mund të gjenden në shumicën e universiteteve evropiane dhe jo domosdoshmërisht duhet të zhvillohet nga fillimi).

Kjo njësi duhet të mbajë një koordinim të vazhdueshëm me strukturat tjera në kuadër të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Grupin Këshillëdhënës, njësitë akademike si dhe strukturat tjera në nivel qeveritar si K-CIRT, CITT në kuadër të MASHT si dhe me agjenci të tjera shtetërore. Njësia duhet të kujdeset dhe të reflektojë edhe në procesin a hartimit/rishikimit të statutit të Universitetit të Prishtinës, proces i cili do të filloj menjëherë pas aprovimit të ligjit të ri për arsimin e lartë.

Ky dokument strategjik duhet të zërthehet në plane operative ku behet definimi i fushave prioritare për kërkime shkencore/artistike bazuar në sukseset dhe dobësitë e Universitetit të Prishtinës, të komunikimit të ngushte me njësitë e saj dhe në bazë të prioriteteve kërkimore nga Programi Kombëtar i Shkencës. Këto plane duhet të përmbajnë, mes tjerash, edhe treguesit e arritjeve, procedurat për monitorimin e progresit, si dhe masat e duhura, përfshirë edhe buxhetin e nevojshëm.

Universiteti i Prishtinës tanimë ka një autonomi të plotë menaxheriale dhe financiare e cila duhet të shfrytëzohet maksimalisht, fillimisht duke definuar qartë të drejtat dhe obligimet e njësive dhe stafit akademik për pjesëmarrje në projekte hulumtuese, zhvillimore dhe konsultative si dhe të drejtat pronësore intelektuale të institucionit dhe individëve (stafit).

Me qëllim të ndërtimit të një sistemi për menaxhim efektiv të punës kërkimore-shkencore/artistike, Universiteti i Prishtinës parasheh masat vijuese:

Masa M1:	Fuqizohet Njësia për mbështetje të hulumtimeve shkencore (NjHSh) në Universitetin e Prishtinës
Përshkrimi:	<p>Kjo Njësi do të merret me analizën e kapaciteteve, procedurave dhe rregulloreve të brendshme që kanë ndikim në aktivitetet kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore dhe do të bart aktivitetet rreth përgatitjes së një plani të detajuar për kërkime shkencore/artistike përmes të cilit synohet edhe gjetja e fondeve për kërkim, planifikimi i shfrytëzimit të fondeve me efikasitet, komercializimi i kapaciteteve infrastrukurore etj.</p> <p>Kjo Njësi, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të Universitetit të Prishtinës, do të kujdeset për zbatimin e vazhdueshëm të kriterëve për sigurimin e cilësisë në kërkime shkencore duke përfshirë stimulime për stafin e suksesshëm.</p> <p>Përveç kësaj, Njësia do të mbajë kontakte të vazhdueshme me palët me interes dhe do të asistoj njësitë dhe stafin e Universitetit të Prishtinës në hartimin e projekteve që përfshijnë ekonominë, dhe shoqërinë. Po ashtu, do të mbaj kontaktet me të diplomuarit të cilët janë të angazhuar neper kompani me qëllim të promovimit të inovacionit, transferit të teknologjisë dhe ndërmarrësisë. Në perspektive, ky funksion i Njësisë për mbështetje të kërkimeve shkencore mund t'i bartet një njësie të veçantë për inovacion, transfer të teknologjisë dhe ndërmarrësi.</p> <p>Kjo njësi do të zhvillojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave për aktivitete kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore.</p>

Rezultatet e pritshme:	<p>M1.1. Prej Janarit 2013 rritet në 3 numri i zyrtarëve të Njesisë dhe është definuar roli i saj në kuadër të statutit të Universitetit të Prishtinës dhe akteve përkatëse rregullative.</p> <p>M1.2. Njësia ofron asistencë teknike për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me palët me interes dhe për planifikimin e të paktën 5 projekteve në vit të cilat përfshijnë ekonominë dhe shoqërinë.</p> <p>M1.3. Zhvillohet sistemi i bazës së të dhënave, përfshirë: kapacitetet nga diaspora në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore; marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe privat të ekonomisë dhe Universitetit të Prishtinës; bashkëpunimin e Universitetit të Prishtinës me ekonominë dhe shoqërinë, etj.</p>
-------------------------------	---

Masa M.2:	Krijohet Grupit Këshillëdhënës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe inovacion në Universitetin e Prishtinës
Përshkrimi:	<p>Statuti aktual përshkruan obligimet që i ka Universiteti i Prishtinës për të ofruar kushte adekuate për kërkime shkencore/artistike dhe se performanca individuale e stafit të Universitetit të Prishtinës në kërkime shkencore/artistike duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e tyre profesional dhe zhvillim të karrierës. Edhe pse nuk i është kushtuar hapësirë e nevojshme, kjo qasje është moderne.</p> <p>Në këtë kuadër, do të themelohet grupi këshillëdhënës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe inovacion cili do të këshillojë menaxhmentin e Universitetit të Prishtinës për të ndërtuar dhe avancuar sistemin e menaxhimit dhe koordinimit të aktiviteteve kërkimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës dhe për të vendosur mekanizmat për përgjegjësinë dhe llogaridhënien e strukturave drejtuese dhe stafit për veprimtari kërkimore shkencore/artistike dhe zhvillimore.</p> <p>Në këtë kuadër, do të hartohen rregullore për obligimet e stafit dhe menaxhmentit në kuadër të aktiviteteve kërkimore shkencore/artistike. Veçmas do të definohen rregullat për pjesëmarrje në projekte, për gjenerimin dhe menaxhimin e mjeteve vetanake dhe të krijohen kushte ligjore për zbatimin e tyre.</p> <p>Duke shfrytëzuar infrastrukturën e Njesisë për mbështetje kërkimeve shkencore/artistike, Grupi Këshillëdhënës do të bëjë një analizë fillestare (baseline study) lidhur me aktivitetet hulumtuese i cili do shfrytëzohet në proces të hartimit të planit të veprimit për punë kërkimore shkencore/artistike në Universitetin e Prishtinës.</p> <p>Ky grup, po ashtu, do të vlerësojë kërkesat dhe projekt-propozimet për mjete financiare nga fondi për kërkime shkencore/artistike universitetit dhe i rekomandon menaxhmentit për financimin e tyre.</p> <p>Ky grup emërohet nga Rektori dhe përbëhet nga 5-7 anëtarë nga radhët e punëtorëve të dalluar kërkimore-shkencor/artistik.</p>

Rezultatet e pritshme:	M2.1. Themelimi dhe funksionalizimi i grupit një muaj pas aprovimit të Strategjisë.
Masa M.3:	Hartohen plane vjetore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të Universitetit të Prishtinës
Përshkrimi:	<p>Njësia për kërkime shkencore, në bashkëpunim me njësitë e Universitetit të Prishtinës do të përgatis planin vjetor për aktivitete kërkimore-shkencore/artistik dhe zhvillimore të Universitetit të Prishtinës duke identifikuar prioritetet dhe caqet në këtë fushë.</p> <p>Në këtë kuadër, edhe Grupi Këshillëdhënës do të jep rekomandimet e veta për masat e nevojshme që duhet ndërmarrë për të përkrahur dhe ngritur nivelin e aktiviteteve kërkimore-shkencore/artistik dhe zhvillimore në Universitetin e Prishtinës.</p>
Rezultatet e pritshme:	M3.1. Plani vjetor i aprovuar.

5. Plani i veprimit dhe buxheti

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Strategjisë, duke filluar nga viti kalendarik 2013, përfundimisht me vitin kalendarik 2016. Kjo periudhë korrespondon me planifikimin buxhetor, duke siguruar një kontinuitet të veprimtarisë kërkimore shkencore/artistike. Është përcaktuar kostoja vetëm për ato masa që nuk mund të kryhen në kuadër të financimit të rregullt të veprimtarisë akademike të Universitetit të Prishtinës. Si plani i veprimit, ashtu edhe buxheti janë të karakterit orientues dhe duhet të rishikohen para fillimit të çdo viti akademik, respektivisht fiskal.

Objektivi 1: Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/ artistike në Universitetin e Prishtinës.

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Masa 1.1: Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës bazuar në sistemin e Bolonjës								
1.1.1	Zhvillohen programet e doktoratës në përputhje me Rregulloren	tetor-mars (në çdo vit akademik)	Njësite akademike					
1.1.2.	Programet aproohen dhe dërgohen për akreditim	prill-maj (në çdo vit akademik)	Senati i Universitetit	€ 40,000	€ 40,000	€ 40,000	€ 40,000	€ 160,000
1.1.3	Shpallet konkursi për regjistrim në studime të doktoratës	shtator 2013 (pastaj çdo vit)	Senati i Universitetit					
Subtotali 1.1				€ 40,000	€ 40,000	€ 40,000	€ 40,000	€ 160,000
Masa 1.2: Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit								
1.2.1	Zhvillohen kriteret dhe procedurat për ndarjen e bursave	janar-mars 2013	NjHSh					
1.2.2	Shpallet konkursi vjetor për bursa	janar dhe qershor (çdo vit)	Menaxhmenti					
1.2.3	Ndahen bursat në përputhje me kriteret	mars dhe shtator (çdo vit)	Menaxhmenti	€ 100,000	€ 100,000	€ 100,000	€ 100,000	€ 400,000
Subtotali 1.2				€ 100,000	€ 100,000	€ 100,000	€ 100,000	€ 400,000
Masa 1.3: Nxitet qasja ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike								
1.3.1	Përcaktohet shuma e fondeve për përkrahje të kërkimeve	qershor (çdo vit)	Menaxhmenti					

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
	ndërdisciplinare							
1.3.2	Caktohen fushat me prioritet për kërkime ndërdisciplinare	shtator-tetor (çdo vit)	Menaxhmenti Grupi Këshillëdhënës NjHSh					
Masa 1.4: Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore-shkencore/artistike								
1.4.1	Hartimi i rregullores për stimulim të personelit	mars-qershor 2013	Grupi Këshillëdhënës NjHSh					
1.4.2	Miratimi i Rregullores	qershor-korrik 2013	Këshilli Drejtues					
Masa 1.5: Nxitet përfshirja e kapaciteteve nga diaspora në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore								
1.5.1	Shpallja e ftesës për shprehje interesi për hulumtuesit nga Diaspora	mars 2013 (pastaj në vazhdimësi)	NjHSh					
1.5.2	Krijimi i bazës së të dhënave për hulumtuesit nga Diaspora	Shtator-tetor 2013	NjHSh					
1.5.3	Plotësimi dhe përditësimi i bazës	në vazhdimësi	NjHSh					
TOTALI 1				€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 560,000

Objektivi 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe për ofrimin e shërbimeve

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Masa 2.1: Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitetin e Prishtinës								
2.1.1	Hartohet metodologjia për inventarizim	maj-shtator 2013	NjHSh					
2.1.2	Mblidhen të dhëna nga njësitë akademike për gjendjen e infrastrukturës kërkimore	shtator-tetor 2013	NjHSh					

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
2.1.3	Zhvillohet baza e të dhënave dhe plotësohet me të dhënat e mbledhura	tetor-nentor 2013	NjHSh					
2.1.4	Analiza e gjendjes së infrastrukturës dhe hartimi i rekomandimeve	dhjetor 2013	Grupi i ekspertëve		€ 16,500 20 ditë konsulence ndërkomb. 30 ditë konsulence vendore			€ 16,500
Subtotali 2.1					€ 16,500			€ 16,500
Masa 2.2: Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të Universitetit të Prishtinës								
2.2.1	Hartohet rregullorja për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve	janar-shkurt 2014	NjHSh					
2.2.2	Miratohet rregullorja për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve	mars-prill 2014	Këshilli Drejtues					
Masa 2.3: Lidhen marrëveshje për shfrytëzim të infrastrukturës kërkimore të institucioneve të tjera në vend dhe jashtë								
2.3.1	Negociohen dhe hartohen marrëveshje me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë	në vazhdimësi	Menaxhmenti					
Masa 2.4: Themelohen/Funksionalizohen laboratorë dhe institute dhe pajisen me infrastrukturë përkatëse								
2.4.1	Zhvillohet Master-Plani për funksionalizimin, ristrukturim dhe modernizim të instituteve kërkimore në kuadër të Universitetit të Prishtinës	mars-qershor 2014	NjHSh Grupi Këshillëdhënës		€ 16,500 20 ditë konsulence ndërkomb. 30 ditë konsulence vendore			€ 16,500
2.4.2	Miratohet Master-Plani për funksionalizimin, ristrukturim dhe modernizim të instituteve kërkimore në kuadër të Universitetit të	shtator 2014	Këshilli Drejtues					

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
	Prishtinës							
2.4.3	Merret vendimi për ndarjen e fondit për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe për pajisje të reja	shtator 2014	Këshilli Drejtues			€ 170,000	€ 170,000	€ 340,000
2.4.4	Përgatiten projekte për themelimin e qendrave të ekselencës në bazë të konkursit të MASHT	në varësi nga konkursi	NjHSh në koordinim me njësitë akademike dhe GK					
2.4.5	Aftësimi i personelit për përdorimin e aparaturave	në vazhdimësi	NjHSh në koordinim me njësitë akademike	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000	€ 40,000
Subtotali 2.4				€ 10,000	€ 26,500	€ 180,000	€ 180,000	€ 396,500
Masa 2.5: Pajisen me literature bashkëkohore bibliotekat ekzistuese dhe sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante								
2.5.1	Sigurohet qasje në biblioteka elektronike	2013-2016	Menaxhmenti		€ 70,000	€ 70,000	€ 70,000	€ 210,000
2.5.2	Sigurohet qasja në resurse on-line të partnerëve strategjikë	në vazhdimësi	Menaxhmenti					
Subtotali 2.5					€ 70,000	€ 70,000	€ 70,000	€ 210,000
TOTALI 2				€ 10,000	€ 113,000	€ 250,000	€ 250,000	€ 623,000

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Masa 3.1: Lidhen partneritete strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës								
3.1.1	Analiza e marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit	shkurt-mars 2013	Grupi Këshillëdhënës NjHSh, ZMJ					

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periodha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
3.1.2	Nxjerrja e rekomandimeve për lidhjen e partneriteteve strategjike	maj 2013	Grupi Këshillëdhënës					
3.1.3	Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve me partnerë	maj-dhjetor 2013	Menaxhmenti					
Masa 3.2: Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve								
3.2.1	Themelohet grupi bërthamë prej 5-7 anëtarë	janar-mars 2013	Menaxhmenti					€ 0
3.2.2	Trajnimi për grupin bërthamë	2013-2016	NjHSh	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 20,000
3.2.3	Ofrimi i asistencës teknike për përgatitjen e projekteve	2013-2016	NjHSh		€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 15,000
3.2.4	Trajnimi për personelin akademik për zhvillimin e projekteve	2013-2016	NjHSh		€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 15,000
Subtotali 3.2				€ 5,000	€ 15,000	€ 15,000	€ 15,000	€ 50,000
Masa 3.3: Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare								
3.3.1	Merret vendimi për ndarjen e fondeve për bashkëfinancim	shtator 2013	Këshilli Drejtues					€ 0
3.3.2	Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare	2013-2016	Këshilli Drejtues	€ 50,000	€ 170,000	€ 170,000	€ 170,000	€ 510,000
Subtotali 3.3					€ 170,000	€ 170,000	€ 170,000	€ 510,000
Masa 3.4: Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar								
3.4.1	Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar	në vazhdimësi	NjHSh					
TOTALI 3				€ 55,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 560,000

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periodha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Masa 4.1: Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat								
4.1.1	Zhvillohet baza e të dhënave	mars-qershor 2013	NjHSh					
4.1.2	Mblidhen informatat nga njësitë akademike dh përfshihen në bazën e të dhënave	qershor-korrik 2013	NjHSh					
4.1.3	Përditësimi i të dhënave në bazë	në vazhdimësi	NjHSh					
4.1.4	Organizimi i takimeve me partnerëve	në vazhdimësi	NjHSh					
Masa 4.2: Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkesat e tregut								
4.2.1	Hartohet Rregullorja për ofrimin e programeve profesionale	Qershor-shtator 2013	ZZhA, NjHSh, Menaxhmenti		€ 5,000			€ 5,000
4.2.2	Aprovohet Rregullorja për ofrimin e programeve profesionale	shtator-tetor 2013	Këshilli Drejtues					
Subtotali 4.2					€ 5,000			€ 5,000
Masa 4.3: Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkime								
4.3.1	Hartimi i një udhëzimi/rekomandimi për krijimin e bordeve të veçanta për fusha të caktuara në nivel të njësisve akademike	prill- maj 2013	Bordi Këshillëdhënës NjHSh					
4.3.2	Prezantimi i udhëzimit para dekanëve	qershor 2013	Menaxhmenti					
Masa 4.4: Angazhohen personeli akademik dhe studentet në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore-shkencore								
4.4.1	Institucionalizimi i intershipeve në sektorin publik dhe privat në formë të një udhëzimi për procedurat e hartimit të kurrikulave	maj-shtator 2013	Menaxhmenti					

Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
4.4.2	Identifikimi i partnerëve potencialë për kryerjen e hulumtimeve	në vazhdimësi	Njësitë akademike , ZZhA					
4.4.3	Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve për internshipe	në vazhdimësi	Menaxhmenti					
TOTALI 4					€ 5,000			€ 5,000

Menaxhimi

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I				
				2013	2014	2015	2016	Gjithsej
Masa M.1: Fuqizohet Njësia për mbështetje të kërkimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës								
M.1.1	Marrja e vendimit për ristrukturimin e NjHSh	mars-prill 2013	Këshilli Drejtues me propozim të menaxhmentit					
M.1.2	Konstituohet përbërja e re e NjHSh (3 persona me pagë [mesatare 450 EUR)	maj 2013	Menaxhmenti	€ 12,150	€ 16,200	€ 16,200	€ 16,200	€ 60,750
Subtotali M.1				€ 12,150	€ 16,200	€ 16,200	€ 16,200	€ 60,750
Masa M.2: Krijohet Grupit Këshillëdhënës për pune kërkimore-shkencore/artistike dhe inovacion në Universitetin e Prishtinës								
M.2.1	Themelohet Grupi Këshillëdhënës	janar-shkurt 2013	Rektori	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 20,000
Subtotali M.2				€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000	€ 20,000
Masa M.3: Hartohen plane vjetore për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të Universitetit të Prishtinës								
	Hartimi i planit vjetor	maj-shtator (çdo vit)	Menaxhmenti me ndihmën e NjHSh					
	Aprovimi i planit vjetor	tetor (çdo vit)	Këshilli Drejtues					
TOTALI Menaxhimi				€ 17,150	€ 21,200	€ 21,200	€ 21,200	€ 80,750

Përmbledhja e buxhetit

Tabela vijuese reflekton një pasqyrë të buxhetit të dedikuar për veprimtari kërkimore-shkencore/artistike, sipas fushave dhe viteve akademike. Në fakt, ky është buxheti i nevojshëm për të ofruar kushtet minimale për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike të organizuar në Universitet, e në përputhje me këtë Strategji. Ndërkaq, fondet për zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe artistike, si rregull, duhet të sigurohen nga burime të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Fusha	Buxheti				
	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16	Gjithsej
Burimet njerëzore	€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 140,000	€ 560,000
Infrastruktura	€ 10,000	€ 113,000	€ 250,000	€ 250,000	€ 623,000
Bashkëpunimi ndërkombëtar	€ 55,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 185,000	€ 560,000
Lidhja me ekonominë dhe me shoqërinë	€ 0	€ 5,000	€ 0	€ 0	€ 5,000
Menaxhimi	€ 17,150	€ 21,200	€ 21,200	€ 21,200	€ 80,750
	€ 222,150	€ 464,200	€ 596,200	€ 596,200	€ 1,828,750

Analiza sipërfaqësore e këtij buxheti tregon se fondet e nevojshme për implementimin e kësaj Strategjie paraqesin 1 – 3.5% të buxhetit vjetor të Universitetit të Prishtinës (rreth 17 mil. EUR), pa i llogaritur të hyrat vetanake nga veprimtaria akademike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e këtyre shpenzimeve janë bërë edhe deri tani, por jo në mënyrë të rregullt dhe të planifikuar.

Është me rëndësi që ky buxhet të rishikohet para fillimit të çdo viti akademik dhe fiskal, duke i alokuar mjetet me kohë dhe në kategoritë buxhetore që i përgjigjen më së miri dedikimit të tyre.

Shtojcë: Prioritetet kërkimore sipas Programit Kombëtar të Shkencës

Programi Kombëtar i Shkencës i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2010 përcakton këto prioritetet kërkimore:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit
3. Kërkimet shkencore në mjekësi
4. Studimet shoqërore dhe ekonomike
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Përveç kësaj, fusha e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese konsiderohet si prioritet ndër-horizontal që mund të shfaqet në cilëndo nga fushat e lartpërmendura.

Temat kryesore që do të trajtohen në kuadër të secilit prioritet janë dhënë më poshtë, me gjithë se kjo listë nuk është përjashtuese:

Prioriteti 1: Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi

- Shfrytëzimi i burimeve natyrore,
- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e qasjes së ekosistemit për menaxhimin e natyrës,
- Menaxhimi i ujit të pijshëm dhe sistemet e trajtimit të ujit të ndotur,
- Trajtimi i ujërave nëntokësore si burim i ujit të pijshëm në zonat rurale,
- Trajtimi i ujit të ndotur në sektorin urban dhe industrial,
- Inventarizimi i florës, faunës dhe kërpudhave në Kosovë,
- Studimi i degradimit të tokës (ndërtimi, konvertimi, fragmentimi, ndotësit, erozioni) dhe konsolidimi i tokës,
- Zbatimi i sistemit të informacionit gjeografik (GIS) në përgatitjen për hartën e ekosistemeve të degraduara dhe rrezikuara,
- Burimet e ndotjes (rrezatimet, metalet e rënda, pesticidet dhe herbicidet) dhe efektet e tyre në qeniet e gjalla,
- Projektimi urban dhe problemet mjedisore.
- Energjia si një instrument për zhvillimin socio-ekonomik,
- Sistemi i energjisë, që nga nxjerrja e energjisë primare tek sistemi i prodhimit të energjisë,
- Energjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm,
- Përmirësimi efektiv i shfrytëzimit të energjisë,

- Kërkesa e integruar dhe mundësia e furnizimit,
- Energjitë e ripërtritshme (diellore, hidroelektrike dhe energjia e erës),
- Konsumi i energjisë dhe popullsia,
- Monitorimi i emetimeve të substancave ndotëse gjatë prodhimit të energjisë, si edhe nga industria e transportit,
- Krijimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për shkak të efekteve të rrezikshme të ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut,
- Ndotja e mjedisit dhe shëndeti i njeriut, dhe gjendja e ekosistemit nga niveli mikroskopik (molekular) deri te sistemi makroskopik,
- Ndotja e ajrit në mjedise të brendshme dhe efektet në shëndetin e njeriut,

Prioriteti 2: Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit

- Siguria e ushqimit, cilësia dhe zbatimi i standardeve të sigurisë në nivel të fermës dhe njësisë përpunuese,
- Teknologjitë e reja për të rritur prodhimin bujqësor,
- Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë (tokës, kafshëve, bimëve, ujitjes, etj),
- Prodhimi i kafshëve, përmirësimi dhe shëndeti i tyre,
- Prodhimi bimor, përmirësimi dhe mbrojtja e bimëve,
- Kontrolli i zoonozave,
- Ndikimi i ndryshimeve globale në prodhimin bujqësor,
- Vlera e shtuar për prodhimet bujqësore duke përmirësuar përpunimin dhe aktivitetet e marketingut,
- Përmirësimi i konkurrencës së prodhimeve bujqësore dhe zëvendësimi i importit me eksport në tregjet e tjera,
- Mbështetje zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes promovimit të aktiviteteve bujqësore dhe atyre jobujqësore pa shkaktuar ndonjë dëm në burimet e mjedisit,
- Mbështetje prodhimit bujqësor dhe shumëllojshmërisë rurale,
- Ruajtja e diversitetit të burimeve gjenetike bujqësore (kafshëve dhe bimëve),
- Rritja e prodhimit dhe shfrytëzimi i pyjeve,
- Përafrimi i politikave të bujqësisë në Kosovë me ato të BE-së.

Prioriteti 3: Kërkimet shkencore në mjekësi

- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e mjekësisë bazike (hulumtime gjenetike, imunologjike dhe farmakoterapeutike),
- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e mjekësisë klinike (hulumtimi i sëmundjeve kardiovaskulare dhe onkologjike),
- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shëndetin publik (parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive, shëndeti mendor, shëndeti i nënës dhe i fëmijës dhe varshmëria nga substancat e ndryshme).

Prioriteti 4: Studimet shoqërore dhe ekonomike

1. Studime për identifikimin e faktorëve që ndikojnë në shfrytëzimin efektiv të burimeve njerëzore, natyrore dhe financiare të Kosovës, drejt zhvillimit të një shoqërie të bazuar në dije, përfshirë, por jo të kufizuara, në këto përmbajtje:
 - Hulumtime mbi promovimin e vargut të vlerave (nga prodhimi primar, përpunimi dhe marketingu i produkteve vendore) që përfshin studime në fushën e prodhimit dhe konsumit,
 - Hulumtime për faktorët që ndikojnë në integrimin e Kosovës në tregjet ndërkombëtare,
 - Hulumtime për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja,
 - Hulumtime për faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe natyrën e marrëdhënie me partnerët e huaj,
 - Hulumtime në lidhje me ndikimin/efektin e stabilitetit institucional dhe sundimin e ligjit në zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.
2. Studime për zhvillimin e arsimit dhe të institucioneve kërkimore që ofrojnë një kuadër të integruar të trekëndëshit efektiv arsim-shkencë-inovacion.
3. Studime për qeverisjen, që përfshijnë sa vijon më poshtë:
 - Hulumtime për qeverisjen ekonomike, në nivelin makro dhe mikro,
 - Studime për sundimin e ligjit brenda kornizës së integritit evropian,
 - Hulumtime për sigurinë publike, si për institucione ashtu edhe për individë,
 - Hulumtime për qeverisje elektronike dhe shërbime elektronike për publikun,
 - Hulumtime për qeverisje financiare dhe zvogëlimin e informalitetit,
 - Hulumtime për zgjidhjen e problemeve sociale si varfëria dhe papunësia, si dhe për zhvillimin e tregut të punës, të prodhimit dhe të shërbimeve.
4. Hulumtime për zhvillimin e kohezionit, të solidaritetit dhe të integritit social. Studime për rrjedhat e normave shoqërore dhe të sjelljes në funksion të integritit në BE.

Prioriteti 5: Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike

1. Studime për aspektin praktik të komunikimit efektiv në të gjitha nivelet dhe strukturat politike dhe shoqërore, si një funksion strategjik për të gjitha fushat e tjera, përfshirë, por jo vetëm, këto tema:
 - Krijimi i bazës së të dhënave për Korpusin e Shqipes në formë elektronike, si bazë e domosdoshme për kërkimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e leksikografisë, të hulumtimit strukturor dhe të shumë nevojave të tjera praktike (përfshirë burimet njerëzore, infrastrukturën, harduerin dhe përshtatjen/zhvillimin e softuerëve, etj).
 - Hulumtime për përdorimin e gjuhës në media dhe komunikim publik, arsim, kulturë, politikë, shkencë dhe biznes në pikëpamje të standardeve ekzistuese, shtresave shoqërore, dhe në lidhje me zhvillimet e mëtejshme në kuadrin e horizonteve evropiane të shoqërisë kosovare.
 - Varietetet gjuhësore dhe identiteti: raportet ndërmjet identitetit social/grupor dhe varieteteve të rëndësishme të gjuhës për çdo grup.
 - Hulumtime për burimet strukturore, leksikore dhe të tjera të gjuhës shqipe, veçanërisht në lidhje me horizontet e reja në kuadrin e shoqërive evropiane dhe perëndimore (terminologji në ekonomi, financa, drejtësi, shoqëri dhe në fusha të tjera me rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror).
 - Studime për marrëdhëniet midis shqipes dhe gjuhëve të tjera të Evropës Juglindore me qëllim të krijimit të kontakteve të ngushta ndërmjet shoqërive përkatëse në rajon (hulumtim dhe mësim të gjuhëve).
 - Përdorimi dhe mësimi i gjuhës në kontekstin e arsimimit.
 - Mësimi i gjuhës për fëmijët e diasporës
 - Studimet gjuhësore tek arbëreshët dhe shqiptarët në vendet si Turqia, Greqia, Italia, Egjipti, Rumania etj.
 - Studimet gjuhësore në fushën e informatikës dhe të teknologjisë
 - Studimet në fushën e terminologjisë shkencore dhe të standardizimit të terminologjisë në gjuhën shqipe
 - Studimet gjuhësore në fushën e historisë së gjuhës dhe të filologjisë klasike
2. Studime shumëdisiplinore të shoqërisë kosovare nga perspektiva kulturore, letrare, artistike dhe folklorike.
 - Hulumtime të vlerave, qëndrimeve, botëkuptimeve dhe ndryshimeve në mënyrën e jetesës dhe të të menduarit.
 - Hulumtime të identiteteve sociale dhe kulturore, të subkulturave dhe të multikulturalizmit në kohën e integritimit dhe të globalizimit.
 - Hulumtime në fushën e gjinive dhe të reprezentimit social.

- Hulumtime nga fusha e arteve (muzikës, arteve pamore, letërsisë, teatrit, filmit etj.), kulturës popullore, traditës dhe folklorit.
- Studimet e letërsisë në aspektin historik, kritik dhe teorik.
- Studimi filologjik dhe botimi kritik i veprave nga trashëgimia si dhe studimet komparativiste të letërsisë.
- Hulumtime nga fusha e sportit dhe lojërave.
- Hulumtime nga fusha e mjedisit jetësor, urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.
- Hulumtime nga fusha e medieeve, komunikimit publik dhe reprezentimit social.

3. Studimet historike që do të promovojnë identitetin kombëtar dhe historinë e Kosovës

- Hulumtimet nga parahistoria.
- Hulumtime të epokës së antikitetit dhe të mesjetës.
- Hulumtime të modernitetit, lëvizjeve kombëtare, shtetësisë dhe demokracisë.
- Hulumtime për shkencat ndihmëse të historisë (arkeologji, arkivistikë, etj.).
- Studime nga fusha e historisë shoqërore-ekonomike, shpirtërore dhe gojore.

Prioriteti 6: Studime ndër-horizontale në Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese

- Risitë e TIK-ut me përqendrim në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe sociale, sigurimin e të dhënave dhe analizave për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.
- Kontributi i TIK-ut për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe mirëqenien sociale, si dhe rolin e saj në lëvizjen drejt shoqërisë së bazuar në dije.
- Zbatimi i inovacioneve të reja si rrjetet elektrike “smart”, telemjekësia, rrjetet inteligjente të transportit, mësimi interaktiv dhe informatika si mjete për operim efikas dhe rrjete të komunikimit të shpejtë.
- Roli i TIK-ut në ndryshimet klimatike (perspektivë në të ardhmen).
- Përdorimi i TIK-ut nga nivelet zyrtare për të zhvilluar një kornizë konceptuale në fusha të ndryshme (në ekonomi, në mjedis, në sistemin arsimor, në sistemin shëndetësor, në administratën publike, etj).
- Promovimi i përmbajtjes relevante të informacionit, mirëbesimit, lirisë së mendimit dhe potencialeve të tjera për inovacion në shoqëri.
- Zhvillimi i rrjeteve “future content”.